



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_/2024

PËR

IDENTIFIKIMIN ELEKTRONIK, SHËRBIMET E BESUARA DHE PORTOFOLIN E  
IDENTITETIT DIGJITAL<sup>1</sup>

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

<sup>1</sup> Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Rregulloren eIDAS 1 nr.910/2014 Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm dhe shfuqizimin e Direktivës 1999/93/EC dhe Rregulloren nr. 2024/1183 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 Prill 2024, që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 910/2014 lidhur me krijimin e Identitetit Digjital Evropian

[Type here]

1. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i një niveli të përshtatshëm të sigurisë në përdorimin e mjeteve të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara duke mundësuar dhe lehtësuar për personat fizik dhe juridik të drejtën për të marrë pjesë në mënyrë të sigurt në shoqërinë digjitale si dhe për të përdorur shërbimet publike dhe private *on line*.

2. Ky ligj gjithashtu përcakton rregullat për:

- a) kushtet për njoftimin e skemave të identifikimit elektronik si dhe Portofolit të Identitetit Digjital;
- b) shërbimet e besuara, veçanërisht për transaksionet elektronike;
- c) nënshkrimin elektronik, vulat elektronike, vulat kohore elektronike, dokumentin elektronik, shërbimit elektronik të regjistruar të transmetimit, autentifikimin e faqeve të internetit, arkivimin elektronik dhe vërtetimin elektronik të attributeve, menaxhimin e pajisjeve të krijimit të nënshkrimit elektronik, menaxhimin e pajisjeve të krijimit të vulës elektronike dhe regjistrat elektronikë.

## Neni 2

### Objekti dhe fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet për shërbimet e besuara, për skemat e identifikimit elektronik, transaksionet elektronike, portofolët digjital si dhe për ofruesit e shërbimeve të besuara, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

2. Ky ligj përcakton kushtet për ndërveprim dhe njohjen ndërkufitare të mjeteve të identifikimit elektronik të personave fizikë dhe juridikë, që bëjnë pjesë nën një skemë të identifikimit elektronik.

3. Ky ligj nuk zbatohet për ofrimin e shërbimeve të besuara të përdorura ekskluzivisht në sisteme të mbyllura, të cilat rrjedhin nga legjislacioni shqiptar apo marrëveshje ndërmjet një grupi të caktuar pjesëmarrësish, si dhe në rastet kur në legjislacionin në fuqi parashikohet ndryshe.

4. Ky ligj nuk prek vlefshmërinë e kontratave ose detyrimeve të tjera ligjore apo procedurale të lidhur me kërkesat specifike të sektorit për sa i përket formës dhe efekteve ligjore bazë.

## Neni 3

### Përkufizimet

Për qëllime të kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. **Identifikim elektronik** është procesi i përdorimit të të dhënave identifikuese të personit në formë elektronike që përfaqësojnë në mënyrë unike një person fizik ose juridik, ose një person fizik që përfaqëson një person juridik;

2. **Mjete të identifikimit elektronik** janë njësi materiale ose jo materiale që përmbajnë të dhënat e identifikimit personal ose karakteristikat që së bashku formojnë identifikuesit, të cilat mundësojnë identifikimin elektronik të sigurt dhe autentifikimin në një shërbim *on-line*;

3. **Të dhënat e identifikimit personal** është një tërësi të dhënash të cilat mundësojnë identifikimin e personit fizik, ose personit juridik, ose personi fizik i cili përfaqëson personin juridik;

[Type here]

4. **“Skema e identifikimit elektronik”** është tërësia e mjeteve dhe sistemeve të identifikimit elektronik, sipas të cilit mjetet e identifikimit elektronik u lëshohen personave fizikë ose juridikë ose personave fizikë që përfaqësojnë persona të tjerë fizikë ose juridikë;
5. **“Autentifikim”** është një proces elektronik që mundëson konfirmimin e identifikimit elektronik të një personi fizik ose juridik ose konfirmimin e origjinës dhe integritetit të të dhënave në formë elektronike;
6. **“Përdorues”** është një person fizik ose juridik, ose një person fizik që përfaqëson një person tjetër fizik ose një person juridik, që përdor shërbime të besuara ose mjete të identifikimit elektronik të ofruara në përputhje me këtë ligj;
7. **“Palë mbështetëse”** është një person fizik ose juridik që mbështetet në identifikimin elektronik, portofolët e identitetit digjital ose mjete të tjera identifikimi elektronik, ose në një shërbim të besuar;
8. **“Organ publik”** është autoriteti shtetëror përgjegjës për ofrimin e shërbimeve publike elektronike, në kuptim të këtij ligji;
9. **“Nënshkrues”** është një person fizik, i cili krijon një nënshkrim elektronik;
10. **“Nënshkrim elektronik”** janë të gjitha të dhënat në formën elektronike, të cilat u bashkëlidhen ose shoqërojnë logjikisht të dhëna të tjera elektronike, që shërbejnë si një mënyrë e vërtetimit të identitetit të nënshkruesit dhe e vërtetësisë së dokumentit të nënshkruar;
11. **“Nënshkrimet elektronike të avancuara”** janë nënshkrimet elektronike, të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji.
12. **“Nënshkrimet elektronike të kualifikuara”** janë nënshkrimet elektronike të avancuara , të cilat janë krijuar nga pajisje për krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar dhe që mbështeten në një certifikatë të kualifikuar për nënshkrimet elektronike;
13. **“Të dhënat e krijimit të nënshkrimit elektronik”** janë të dhëna unike që përdoren nga nënshkruesi për të krijuar një nënshkrim elektronik;
14. **“Certifikatë për nënshkrim elektronik”** është një vërtetim elektronik që lidh të dhënat e verifikimit të nënshkrimit elektronik me një person fizik dhe konfirmon të paktën emrin ose pseudonimin e atij personi;
15. **“Certifikatë e kualifikuar për nënshkrimin elektronik”** është një certifikatë për nënshkrim elektronik, që është lëshuar nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar dhe plotëson kushtet e përcaktuara në aneksin I të këtij ligji;
16. **“Shërbimi i besuar”** është shërbimi elektronik i ofruar me pagesë i cili konsiston në:
  - a) lëshimin e certifikatave për nënshkrimet elektronike, certifikatat për vulat elektronike, certifikatat për autentifikimin e faqes së internetit ose certifikatat për ofrimin e shërbimeve të tjera të besuara;
  - b) vërtetimin e certifikatave për nënshkrimet elektronike, certifikatat për vulat elektronike, certifikatat për autentifikimin e faqes së internetit ose certifikatat për ofrimin e shërbimeve të tjera të besuara;
  - c) krijimin e nënshkrimeve elektronike ose vulave elektronike;
  - d) vlefshmërinë e nënshkrimeve elektronike ose vulave elektronike;

[Type here]

- e) ruajtjen e nënshkrimeve elektronike, vulave elektronike, certifikatave për nënshkrime elektronike ose certifikatave për vula elektronike;
  - f) menaxhimin e pajisjeve për krijimin e nënshkrimeve elektronike në distancë (*remote*) ose pajisjeve të krijimit të vulave elektronike në distancë;
  - g) lëshimin e vërtetimeve elektronike të attributeve;
  - h) vlefshmërinë e vërtetimit elektronik të attributeve;
  - i) krijimin e vulave elektronike kohore;
  - j) vlefshmërinë e vulave kohore elektronike;
  - k) ofrimin e shërbimeve të transmetimit (*delivery*) elektronik të regjistruar;
  - l) vërtetimin e të dhënave të transmetuara nëpërmjet shërbimeve të regjistruara elektronikedhe dëshmime përkatëse;
  - m) arkivimin elektronik të të dhënave elektronike dhe dokumenteve elektronike;
  - n) regjistrimin e të dhënave elektronike në një regjistër elektronik;
17. **“Shërbim i besuar i kualifikuar”** është një shërbim i besuar i cili ofron nënshkrime elektronike të kualifikuara dhe vula kohore të kualifikuara, vula elektronike të kualifikuara, shërbim të regjistruar të kualifikuar të transmetimit elektronik, certifikata të kualifikuara për autentifikim faqesh interneti, mundësimin e identifikimit elektronik të sigurt nëpërmjet mjeteve të identifikimit elektronik të përdorura brenda një skeme të identifikimit elektronik, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
18. **“Organe të vlerësimit të konformitetit”** janë organet kompetente të akredituara për të kryer vlerësimet e konformitetit të veprimtarisë së një Ofruesi të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar ose shërbimeve të besuara të ofruara prej tij ose certifikimin e portofolit të identitetit digjital ose të mjeteve të identifikimit elektronik;
19. **“Ofruesi i Shërbimit të Besuar”** është person fizik ose juridik, publik ose privat, i cili ofron një ose më shumë shërbime të besuara jo të kualifikuara;
20. **“Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar”** është një ofrues i shërbimit të besuar, që ofron një apo më shumë shërbime të besuara, të cilit i është dhënë statusi i kualifikuar nga Autoriteti;
21. **“Produkt”** është *hardware* ose *software*, ose komponentët përkatës të *hardware* ose *software*, të cilat përdoren për ofrimin e shërbimeve të besuara dhe identifikimin elektronik;
22. **“Pajisje të krijimit të nënshkrimit elektronik”** janë produkte *hardware* dhe *software* të konfiguruar për këtë qëllim, për të krijuar një nënshkrim elektronik;
23. **“Pajisje e krijimit të nënshkrimit elektronik të kualifikuar në distancë”** është një mjet i krijimit të nënshkrimit elektronik që menaxhohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar në përputhje me nenin 37 të këtij ligji në emër të një nënshkruesi.
24. **“Pajisje të krijimit të vulës elektronike të kualifikuar”** është mjet i krijimit të vulës elektronike, që menaxhohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar në përputhje me nenin 49 të këtij ligji në emër të një krijuesi të vulës;
25. **“Krijuesi i një vule elektronike”** është një person juridik, i cili krijon një vulë elektronike;

[Type here]

26. **“Vulë elektronike”** janë të dhëna në formë elektronike të cilat janë bashkangjitur ose të lidhura logjikisht me të dhëna të tjera elektronike, për të siguruar origjinën dhe integritetin e këtyre të fundit;
27. **“Vulë elektronike e avancuar”** është një vulë elektronike, e cila i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 45 të këtij ligji;
28. **“Vulë elektronike e kualifikuar”** është vulë elektronike e avancuar e cila është krijuar nga një pajisje krijimi vule elektronike të kualifikuar, dhe është e bazuar në një certifikatë të kualifikuar për vulë elektronike;
29. **“Të dhënat e krijimit të vulës elektronike”** janë të dhëna unike, të cilat përdoren nga krijuesi i vulës elektronike, për të krijuar një vulë elektronike.
30. **“Certifikatë për vulë elektronike”** është një vërtetim elektronik që lidh të dhëna të vërtetimit të vlefshmërisë së vulës elektronike me një person juridik dhe konfirmon emrin e këtij personi;
31. **“Certifikatë e kualifikuar për vulë elektronike”** është një certifikatë për vulë elektronike, që është lëshuar nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar dhe plotëson kriteret e përcaktuara në në Aneksin III;
32. **“Pajisje e krijimit të vulës elektronike”** është produkt *software* ose *hardware* i konfiguruar për këtë qëllim, i cili përdoret për të krijuar një vulë elektronike;
33. **“Pajisje të krijimit të vulës elektronike të kualifikuar”** është mjet i krijimit të vulës elektronike, i cili plotëson kriteret *e mutatis mutandis* kërkesat e përcaktuara në aneksin II të këtij ligji;
34. **“Vulë kohore elektronike”** janë të dhënat në formë elektronike, të cilat lidhin të dhëna të tjera në formë elektronike me një kohë të caktuar që vërtetojnë se këto të dhëna kanë ekzistuar në atë kohë;
35. **“Vulë kohore elektronike e kualifikuar”** janë vula kohore elektronike të lëshuara nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, e cila plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 53 të këtij ligji;
36. **“Dokument elektronik”** sipas këtij ligji, ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për qeverisjen elektronike.
37. **“Shërbim elektronik i regjistruar”** është një shërbim që bën të mundur transmetimin e të dhënave midis palëve të treta nëpërmjet mjeteve elektronike dhe siguron provë në lidhje me trajtimin e të dhënave të transmetuara, duke përfshirë dëshmi mbi dërgimin dhe marrjen e të dhënave dhe që mbron të dhënat e transmetuara kundër rrezikut të humbjes, vjedhjes, dëmtimit apo çdo ndryshimi tjetër të paautorizuar;
38. **“Shërbim elektronik i kualifikuar i regjistruar”** është një shërbim i transmetimit elektronik, ofrimi i të cilit plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 55 të këtij ligji;
39. **“Certifikatë për autentifikim faqesh interneti”** është një vërtetim i cili bën të mundur autentifikimin e një faqeje interneti dhe lidh faqen e internetit me personin fizik apo juridik, të cilit i është lëshuar kjo certifikatë;
40. **“Certifikatë e kualifikuar për autentifikim faqesh interneti”** është një certifikatë për autentifikim faqesh interneti, e cila është lëshuar nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar dhe plotëson kriteret e përcaktuara në Aneksin IV të këtij ligji;
41. **“Të dhënat e vërtetimit të vlefshmërisë”** janë të dhëna të cilat përdoren për të vërtetuar një nënshkrim elektronik ose vlefshmërinë e një vule elektronike”.

[Type here]

42. **“Vlerifikimi”** është procesi i verifikimit dhe konfirmimit të të dhënave në formë elektronike që janë të vlefshme në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj;
43. **“Portofoli i identitetit digjital”** është një mjet identifikimi elektronik që i lejon përdoruesit të ruajë, menaxhojë dhe vërtetojë në mënyrë të sigurt të dhënat e identifikimit të personit dhe vërtetimeve elektronike të attributeve me qëllim ofrimin e tyre palëve të tjera dhe përdoruesve të tjerë të portofoleve të identitetit digjital dhe të nënshkruajë me anë të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ose të vulosë me anë të vulave elektronike të kualifikuara;
44. **“Atribut”** nënkupton një karakteristikë, cilësi, të drejtë ose leje të një personi fizik ose juridik ose të një objekti;
45. **“Vërtetim elektronik i attributeve”** nënkupton një vërtetim në formë elektronike që lejon autentifikimin e attributeve;
46. **“Vërtetim elektronik i kualifikuar i attributeve”** nënkupton një vërtetim elektronik të attributeve, i cili lëshohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuara dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në Aneksin V të këtij ligji;
47. **“Vërtetim elektronik i attributeve të lëshuar nga ose në emër të një organi të sektorit publik përgjegjës për një burim autentik”** është një vërtetim elektronik i attributeve të lëshuara nga një organ i sektorit publik që është përgjegjës për një burim autentik ose nga një organ i sektorit publik që është caktuar si i tillë për të lëshuar vërtetime të tilla të attributeve në emër të organeve të sektorit publik përgjegjës për burimet autentike në përputhje me nenin 62 dhe me aneksin VII;
48. **“Burim autentik”** është një magazinë ose sistem, i mbajtur nën përgjegjësinë e një organi të sektorit publik ose subjektit privat, që përmban dhe ofron attribute për një person fizik ose person juridik ose objekt dhe që konsiderohet të jetë burimi kryesor i atij informacioni ose i njohur si autentik në përputhje me ligjin kombëtar, ose legjislacionin e Bashkimit Evropian duke përfshirë edhe praktikën administrative;
49. **“Arkivim elektronik”** është një shërbim që siguron, ruajtjen, rikthimin dhe fshirjen e të dhënave elektronike dhe dokumenteve elektronike me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria dhe lexueshmëria e tyre, si dhe të ruhet integriteti, konfidencialiteti dhe vërtetimi i origjinës gjatë gjithë periudhës së ruajtjes;
50. **“Shërbim i arkivimit elektronik të kualifikuar”** nënkupton një shërbim arkivimi elektronik i cili ofrohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar dhe që plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 66 të këtij ligji;
51. **“Marka e besuar e portofolit të identitetit digjital ”** nënkupton një tregues të verifikueshëm, të thjeshtë dhe të dallueshëm, i cili komunikon në mënyrë të qartë se portofoli i identitetit digjital është siguruar në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj;
52. **“Autentifikim i fortë i përdoruesit”** është një autentifikim i bazuar në përdorimin e të paktën dy faktorëve të kategorive të ndryshme të autentifikimit si njohuria, posedimi elementët biometrik të përdoruesit të cilat janë të pavaruar nga njëra tjetra ku shkëlja e njërit nuk cenon besueshmërinë e të tjerëve dhe është projektuar në mënyrë të tillë që të mbrojë konfidencialitetin e të dhënave të autentifikimit;

[Type here]

53. **“Regjistër elektronik”** është një renditje e regjistrimeve elektronike të të dhënave, që siguron integritetin dhe saktësinë e renditjes kronologjike të këtyre regjistrimeve;
54. **“Regjistër elektronik i kualifikuar”** është një regjistër elektronik i cili ofrohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar i cili plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 68 të këtij ligji;
55. **“Të dhëna personale”**; sipas këtij ligji, ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
56. **“Përputhja e identitetit”** është një proces ku të dhënat e identifikimit të personit ose mjetet elektronike të identifikimit përputhen ose lidhen me një llogari ekzistuese që i përket të njëjtit person;
57. **“Regjistrim i të dhënave”** janë të dhënat elektronike të regjistruara së bashku me shpjegimet përkatëse që mbështesin përpunimin e të dhënave;
58. **“Offline mode”** është një ndërveprim ndërmjet një përdoruesi dhe një pale të tretë në një vendndodhje fizike duke përdorur teknologji që procesojnë në afërsi, ku portofolit të identitetit digjital nuk i kërkohet të aksesojë sistemet në distancë nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik për qëllime të ndërveprimit.
59. **“Autoriteti”** është autoriteti përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e fushës së identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara, i krijuar nëpërmjet ligjit për sigurinë kibernetike në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 4**

##### **Parimi i tregut të brendshëm**

1. Me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian nuk do të ketë asnjë kufizim në ofrimin e shërbimeve të besuara në territorin e një Shteti Anëtar nga një ofrues i shërbimeve të besuara themeluar në Republikën e Shqipërisë të cilët operojnë brenda fushave të përcaktuara në këtë ligj;
2. Produktet dhe shërbimet e besuara që plotësojnë kërkesat e këtij ligji, lejohen të qarkullojnë lirshëm në tregun e brendshëm evropian.

#### **Neni 5**

##### **Përdorimi i pseudonimit**

Në një transaksion elektronik lejohet përdorimi i pseudonimeve.

#### **Neni 6**

##### **Portofoli i Identitetit Digjital**

1. Me qëllim që të sigurohet që të gjithë personat fizikë dhe juridikë të kenë akses të sigurt, të besueshëm dhe të pandërprerë në shërbimet publike dhe private, duke patur kontroll të plotë mbi të dhënat e tyre,

[Type here]

2. Republika e Shqipërisë do të sigurojë të paktën një portofol të identitetit Digjital.

3. Kodi burim i komponentëve të software të aplikacionit të Portofolit të Identitetit Digjital të sigurohet të jetë me burim të hapur të licencuar. Për arsye të justifikuara, kodi burim i komponentëve të veçantë të ndryshëm nga ata të instaluar në pajisjet e përdoruesit nuk ekspozohen.

4. Portofoli i Identitetit Digjital i mundëson përdoruesit, një mënyrë të lehtë përdorimi, transparente, të gjurmueshme prej tij me qëllim që të:

a) kërkojë, marr, zgjedh, kombinoj, ruaj, fshijë, shpërndaje dhe paraqesë në mënyrë të sigurt, nën kontrollin e vetëm të tij, të dhënat e identifikimit të personit dhe, kur është e zbatueshme, në kombinim me vërtetimet elektronike të attributeve, për t'u vërtetuar palëve të përfshira online dhe në *modalitetin offline*, me qëllim pasjen akses në shërbimet publike dhe private, duke siguruar, aty ku është e mundur marrjen selektive të të dhënave;

b) gjenerojë pseudonime dhe t'i ruajë ato të koduara brenda Portofolit të Identitetit Digjital;

d) ketë akses në loge të të gjitha transaksioneve të kryera përmes Portofolit të Identitetit Digjital nëpërmjet një paneli të përbashkët që i mundëson përdoruesit të:

i) shikojë një listë të përditësuar të palëve të përfshira me të cilat ai ka krijuar një lidhje dhe, sipas rastit, të gjitha të dhënat e shkëmbyera;

ii) kërkojë lehtësisht fshirjen nga një palë e përfshirë të të dhënave personale në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

iii) raportojë një palë të përfshirë tek autoriteti përgjegjës i mbrojtjes së të dhënave personale, kur merret një kërkesë për të dhëna e cila është e paligjshme ose e dyshimtë;

(e) nënshkruajë me anë të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ose të vulos me anë të vulave elektronike të kualifikuara;

f) shkarkojë, për aq sa është teknikisht e mundur, të dhënat e tij, vërtetimin elektronik të attributeve dhe konfigurimet;

g) ushtrojë të drejtat e përdoruesit për transferimin e të dhënave.

5. Portofoli i Identitetit Digjital, në veçanti:

(a) mbështet protokollet dhe ndërfaqet e zakonshme:

(i) për lëshimin e të dhënave të identifikimit të personit, vërtetimeve elektronike të kualifikuara dhe të pakualifikuara të attributeve ose certifikatave të kualifikuara dhe të pakualifikuara në Portofol;

(ii) për të kërkuar dhe vërtetuar të dhënat e identifikimit të personit dhe vërtetimet elektronike të attributeve për palët e përfshira;

(iii) për ndarjen dhe paraqitjen e të dhënave të identifikimit të personit, vërtetimin elektronik të attributeve ose të të dhënave të lidhura të marra në mënyrë përzgjedhëse online dhe në *modalitetin offline* për palët e përfshira;

(iv) për të lejuar përdoruesin të ndërveprojë me Portofolin e Identitetit Digjital dhe të shfaqë një Markë të besuar të këtij Portofoli;

(v) për regjistrimin dhe verifikimin e sigurt të përdoruesit në një sistem ose shërbim duke përdorur një mjet identifikimi elektronik;

[Type here]



(vi) për ndërveprim ndërmjet Portofoleve të Identitetit Digjital të dy personave me qëllim të marrjes, vërtetimit dhe ndarjes së të dhënave të identifikimit të personit dhe vërtetimeve elektronike të attributeve në mënyrë të sigurt;

(vii) për autentifikimin dhe identifikimin e palëve të përfshira duke zbatuar mekanizmat e autentifikimit në përputhje me nenin 7 të këtij ligji;

(viii) për palët e përfshira për të verifikuar vërtetësinë dhe vlefshmërinë e Portofoleve të Identitetit Digjital;

(ix) për t'i kërkuar palës se përfshirë fshirjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

(x) për raportimin e një pale të përfshirë te autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale kur është marrë një kërkesë për të dhëna të paligjshme ose të dyshimta

(xi) për krijimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ose vulave elektronike nëpërmjet nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ose pajisjeve për krijimin e vulave elektronike;

b) të mos japë asnjë informacion tek ofruesit e shërbimeve të besuara të vërtetimeve elektronike të attributeve në lidhje me përdorimin e këtyre vërtetimeve elektronike;

c) të sigurojë që palët e përfshira të vërtetohen dhe identifikohen duke zbatuar mekanizmat e autentifikimit në përputhje me nenin 7 të këtij ligji;

d) të përmbushë kërkesat e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji në lidhje me nivelin e lartë të sigurisë, veçanërisht kur zbatohet për kërkesat për vërtetimin dhe verifikimin e identitetit, menaxhimin dhe vërtetimin e mjeteve të identifikimit elektronik;

e) në rastin e vërtetimit elektronik të attributeve me politika të paracaktuara, zbatohet mekanizmi i duhur për të informuar përdoruesin se pala e përfshirë ose përdoruesi i Portofolit që kërkon që vërtetimi elektronik i attributeve ka të drejten e aksesit në këto vërtetime;

f) të sigurojë që të dhënat e identifikimit të personit, të cilat janë të disponueshme nga skema e identifikimit elektronik, sipas së cilës ofrohet Portofoli përfaqësojnë mënyrë unike personin fizik, personin juridik ose personin fizik që përfaqëson personin fizik ose juridik dhe është i lidhur me Portofolin;

g) t'u ofrojë të gjithë personave fizikë mundësinë për të nënshkruar me anë të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara pa pagesë.

Pavarësisht përcaktimit të shkronjës (g) të kësaj pike RSH mund të parashikohen masa proporcionale për të siguruar që përdorimi i nënshkrimeve elektronike të kualifikuara pa pagesë nga personat fizikë është i kufizuar për qëllime joprofesionale.

6. Ofruesi i shërbimit të Portofolit të Identitetit Digjital informon menjehere përdoruesit për çdo shkelje të sigurisë që mund të ketë komprometuar tërësisht ose pjesërisht Portofolin e tyre ose përmbajtjen e tij, veçanërisht nëse Portofoli i tyre është pezulluar ose revokuar në përputhje me nenin 10 të këtij ligji.

7. Pa rënë ndesh me nenin 11, Republika e Shqipërisë mund të parashikojë, në përputhje me legjislacionin kombëtar, për funksione shtesë të Portofoleve të Identitetit Digjital, duke përfshirë ndërveprueshmërinë me mjetet ekzistuese kombëtare të identifikimit elektronik. Këto funksione shtesë do të jenë në përputhje me këtë nen.

[Type here]

8. Republika e Shqipërisë siguron mekanizma të vlefshmërisë pa pagesë, me qëllim që:
- të sigurojë që autenticiteti dhe vlefshmëria e portofoleve të identitetit Digjital mund të verifikohet;
  - të lejojë përdoruesit të verifikojnë vërtetësinë dhe vlefshmërinë e identitetit të palëve te treta të regjistruara në përputhje me nenin 7 të këtij ligji.
9. Republika e Shqipërisë siguron që vlefshmëria e Portofolit të Identitetit Digjital revokohet në rrethanat e mëposhtme:
- me kërkesë të qartë të përdoruesit;
  - kur siguria e Portofolit të Identitetit Digjital është komprometuar;
  - me vdekjen e përdoruesit ose me ndërprerjen e veprimtarisë së personit juridik.
10. Ofruesit e portofoleve të Identitetit Digjital sigurojnë që përdoruesit të mund të kërkojnë lehtësisht mbështetje teknike dhe të raportojnë probleme teknike ose çdo incident tjetër që ka një ndikim negativ në përdorimin e Portofoleve
11. Portofolet sigurohen sipas një skeme identifikimi elektronik me nivel të lartë sigurie.
12. Portofolet garantojnë siguri që ne dizajnim.
13. Lëshimi, përdorimi dhe revokimi i Portofoleve është pa pagesë për të gjithë personat fizikë.
14. Përdoruesit kanë kontroll të plotë në përdoriminte të dhënave në Portofolin e tyre. Ofruesi i Portofolit nuk do të mbledhë informacione në lidhje me përdorimin e Portofolit, i cili nuk është i nevojshëm për ofrimin e shërbimeve të Portofolit, as nuk do të ndërlidh të dhëna të identifikimi të personit ose ndonjë të dhënë tjetër personale të ruajtur ose në lidhje me përdorimin e Portofolit të Identitetit Digjital me të dhëna personale nga çdo shërbim tjetër i ofruar nga ai ofrues ose nga shërbime të palëve të treta, të cilat nuk janë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të Portofolit të Identitetit Digjital, përveç nëse përdoruesi ka kërkuar shprehimisht ndryshe. Të dhënat personale në lidhje me ofrimin e Portofolit të Identitetit Digjital do të mbahen logjikisht të ndara nga çdo e dhënë tjetër e mbajtur nga ofruesi i Portofolit të Identitetit Digjital. Nëse Portofoli i Identitetit Digjital ofrohet nga palë private në përputhje me pikën 2, shkronjën (b) dhe (c) të këtij neni, dispozitat e nenit 64, pika 3 të këtij ligji do të zbatohen për aq sa është e mundur.
15. Përdorimi i Portofoleve është vullnetar. Aksesit në shërbimet publike dhe private, në tregun e punës dhe liria për të kryer biznes nuk kufizohet në asnjë mënyrë apo të bëhen të pafavorshme për personat fizikë ose juridikë që nuk përdorin Portofolet. Aksesit në shërbimet publike dhe private do të vijoj të bëhet me mjete të tjera ekzistuese identifikimi dhe vërtetimi.
16. Kriteret teknike të Portofolit të Identitetit Digjital:
- nuk lejojnë ofruesit e vërtetimeve elektronike të attributeve ose ndonjë palë tjetër, pas lëshimit të vërtetimit të attributeve, të marrin të dhëna që lejojnë gjurmimin, e transaksioneve ose sjelljes së përdoruesit, lidhjen ose ndërlidhjen e tyre, ose njohuritë e transaksioneve ose sjelljen e përdoruesit, përveçese kur autorizohet nga përdoruesi;
  - bejne te mundur teknikisht ruajtjen e privatësisë kur ka mospëlqim, ku vërtetimi i attributeve nuk kërkon identifikimin e përdoruesit.

[Type here]

17. Çdo përpunim i të dhënave personale i kryer nga ofruesi i portofoleve ose në emër të tyre nga organet ose palët përgjegjëse, kryhet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

18. Me anëtarësimin në Bashkimin Evropian, Republika e Shqipërisë njofton Komisionin Evropian lidhur me:

a) organin përgjegjës për krijimin dhe mbajtjen e listës së palëve përfshira të regjistruara që mbështeten në Portofolin e Identitetit Digjital në përputhje me nenin 7 të këtij ligji dhe vendndodhjen e asaj listë;

b) organet përgjegjëse për ofrimin e portofolit në përputhje me nenin 6 të këtij ligji.

c) organet përgjegjëse që sigurojnë që të dhënat e identifikimit të personit janë të lidhura me Portofolin e Identitetit Digjital në përputhje me nenin 6, pika 5, shkronja “f”;

d) mekanizmin që lejon vërtetimin e të dhënave të identifikimit të personit të përmendura në nenin dhe të identitetit të palëve mbështetëse;

e) mekanizmin me anë të të cilit vërtetohet autenticiteti dhe vlefshmëria e Portofolit të Identitetit Digjital.

19. Përcaktimet e nenit 11 zbatohen për aq sa është e mundur pa rënë ndesh me përcaktimet e pikës 22 të këtij neni.

20. Përcaktimet në pikat b, d-h të pikës 2 të nenit 31 zbatohen për aq sa është e mundur edhe për ofruesit e portofolëve të identitetit digjital.

21. Portofolet e Identitetit Digjital bëhen të aksesueshme për përdorim, nga personat me aftësi të kufizuara, njëloj me përdoruesit e tjerë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara

22. Përcaktimet e bëra në nenet 13, 15,16,19 dhe 20 nuk do të zbatohen për ofrimin e portofolëve të identitetit digjital dhe skemave të identifikimit elektronik.

## Neni 7

### Palët e përfshira në Portofolin e Identitetit Digjital

1. Kur një palë që mbështetet në Portofolin Digjital synon të ofrojë shërbime publike ose private të portofolit me anë të ndërveprimit digjital, pala e trete duhet të regjistrohet në autoritetin përgjegjës.

2. Procesi i regjistrimit është me kosto efektive dhe proporcional me rrezikun. Pala e përfshirë siguronë të paktën:

(a) informacionin e nevojshëm për tu autentifikuar në portofolin, i cili minimalisht përfshin:

(i) selinë në të cilin është e vendosur; dhe

(ii) emrin dhe, kur është e zbatueshme, numrin e regjistrimit siç është deklaruar në një procesverbal zyrtar së bashku me të dhënat identifikuese të atij procesverbali zyrtar;

(b) detajet e kontaktit;

(c) përdorimin e portofoleve, duke përfshirë një tregues të të dhënave që do të kërkohen nga pala për përdoruesin.

[Type here]

3. Palët e përfshira nuk mund t'i kërkojnë përdoruesve të japin ndonjë të dhënë tjetër përveç atyre të përcaktuara në pikën 2, shkronja (c) e këtij neni.
4. Autoriteti publikon informacionin sipas pikes 2, në formë të nënshkruar ose të vulosur në mënyrë elektronike të përshtatshme për përpunim të automatizuar.
5. Palët e përfshira të regjistruara në përputhje me këtë nen informojnë Autoritetin përgjegjës për çdo ndryshim në informacionin e dhënë sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij neni.
6. Autoriteti siguron një mekanizëm të përbashkët për të lejuar identifikimin dhe vërtetimin e palëve të përfshira, siç përmendet në nenin 6 pika 5, shkronja c) e këtij ligji.
7. Kur palët e përfshira synojnë të njihen në Portofolet të Identitetit Digjital, ato duhet të identifikohen te përdoruesi.
8. Palët e përfshira janë përgjegjëse për kryerjen e procedurës për autentifikimin dhe vërtetimin e të dhënave të identifikimit të personit dhe vërtetimin elektronik të attributeve të kërkuara nga Portofolet Palët e përfshira nuk ë refuzojnë përdorimin e pseudonimeve, kur nuk kërkohet identifikimi i përdoruesit.
9. Personat e autorizuar që veprojnë në emër të palëve të përfshira konsiderohen si palë të përfshira/mbështetëse dhe nuk ruajnë të dhëna për përmbajtjen e transaksionit.

## **Neni 8**

### **Certifikimi i Portofolëve të Identitetit Digjital**

1. Konformiteti i Portofoleve dhe skema e identifikimit elektronik certifikohen nga organi i vlerësimit të konformitetit , sipas kerkesave te përcaktuara në nenin 6 pika 4, 5, 8, 14.
2. Certifikimi i konformitetit të Portofoleve me kërkesat e referuara në piken 1 të këtij neni, ose pjesëve të tyre, që janë të rëndësishme për sigurinë kibernetike, kryhet në përputhje me përcaktimet e bëra në kuadrin ligjor në fuqi për sigurinë kibernetike lidhur me skemat e certifikimit të sigurisë kibernetike.
3. Për kërkesat e përmendura në piken 1 të këtij neni që nuk lidhen me sigurinë kibernetike, dhe për kërkesat e përmendura në piken 1 të këtij neni që lidhen me sigurinë kibernetike, në skemen e certifikimit të sigurisë kibernetike te permendura në piken 2 te këtij neni nuk mbulon, ose e mbulon vetëm pjesërisht, ato kërkesa të sigurisë kibernetike. Gjithashtu për këto kërkesa, Shqipëria do të krijojë skema kombëtare të certifikimit duke zbatuar kërkesat e përcaktuara në aktet e përmendura në piken 6 të këtij neni. Me anëtarësimin në BE, Autoriteti do të paraqesë projekt-skemën kombëtare të certifikimit Grupit Evropian të Bashkëpunimit të Identitetit Digjital.
4. Certifikimi sipas pikës 1 të këtij neni është i vlefshëm deri në pesë vjet, me kusht që një vlerësim i vulnerabilitetit të kryhet çdo dy vite. Në rastin kur një vulnerabilitet identifikohet dhe nuk korrigjohet në kohën e duhur, certifikimi anulohet.
5. Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji në lidhje me përpunimin e të dhënave personale bëhet në përputhje me ligjislacionin ne fuqi për mbrojtjen e të dhenave personale.

[Type here]

6. Autoriteti miraton standardet, referencat dhe procedurat për certifikimin e Portofoleve në përputhje me përcaktimet e bëra nga Komisioni Evropian.
7. Me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian , Autoriteti i dërgon Komisionit emrat dhe adresën e organeve të vlerësimit të konformitetit.

## **Neni 9**

### **Publikimi i listës të portofoleve të identitetit Digjital të certifikuar**

1. Me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian Autoriteti informon Komisionin dhe Grupin e Bashkëpunimit, pa vonesa të panevojshme, për Portofolet e Identitetit Digjital që janë siguruar në përputhje me nenin 6 dhe të certifikuara nga organet e vlerësimit të konformitetit të përmendura në nenin 8, si dhe rastet e anulimit të një certifikimi dhe arsytet e anulimit sipas nenit 8 pika 1 të këtij ligji. Lista e Portofoleve të identitetit Digjital të certifikuar publikohet ne faqen zyrtare të Autoritetit.
2. Pa rene ndesh me nenin 6 pika 18 të këtij ligji, informacioni i ofruar nga Republika e Shqipërisë i përmendur në pikën 1 të këtij neni përfshin të paktën:
  - a) certifikatën dhe raportin e vlerësimit të certifikimit të portofolit të identitetit Digjital
  - b) një përshkrim të skemës së identifikimit elektronik sipas së cilës ofrohet Portofoli i Identitetit Digjital;
  - c) regjimin e zbatueshëm të mbikëqyrjes dhe informacionin mbi regjimin e përgjegjësive në lidhje me palën që ofron Portofolin të Identitetit Digjital;
  - d) autoriteti ose autoritetet përgjegjëse për skemën e identifikimit elektronik
  - e) marrëveshjet për pezullimin ose revokimin e skemës së identifikimit elektronik ose të autentifikimit ose të pjesëve të kompromentuara në fjalë
3. Autoriteti krijon dhe mban në një formë të lexueshme elektronike një listë të portofoleve të certifikuar të identitetit digjital dhe i publikon në faqen zyrtare të tij.

## **Neni 10**

### **Kërkesat e sigurisë së Portofolëve Digjital**

1. Kur Portofolet e Identitetit Digjital të parashikuara në përputhje me nenin 6, mekanizmat e vlefshmërisë të përmendura në nenin 6 pika 8 ose skemën e identifikimit elektronik sipas së cilës ofrohen janë shkelur ose kompromentuar pjesërisht në një mënyrë që ndikon në besueshmërinë e tyre ose besueshmërinë e portofoleve të tjera të identitetit digjital, Autoriteti pezullon menjëherë dhënien dhe përdorimin e tyre.

Në varësi të shkallës së shkeljes së sigurisë ose kompromentimit të përmendur në nënparagrafin e 1, Autoriteti tërheq menjëherë Portofolet e Identitetit Digjital.

Autoriteti informon përdoruesit e prekur, palët e përfshira, piken e vetme të kontaktit të përcaktuara në përputhje me nenin 72 pika 1 të këtij ligji;

[Type here]

2. Kur shkelja e sigurisë ose kompromentimi i përmendur në pikën 1, nënparagrafi i parë i këtij neni nuk korrigjohet brenda tre muajve nga pezullimi, Autoriteti revokon vlefshmërinë e tij. Autoriteti informon përdoruesit e prekur palët e treta, piken e vetme të kontaktit të përcaktuara në përputhje me nenin 72 pika 1 të këtij ligji.

3. Kur shkelja e sigurisë ose komprometimi i përmendur në pikën 1, nënparagrafi i parë i këtij neni korrigjohet, Autoriteti siguron rikthimin dhe përdorimin e Portofolit të Identitetit Digjital dhe informon menjehere përdoruesit e prekur, palët e përfshira, piken e vetme të kontaktit të përcaktuara në përputhje me nenin 72 pika 1 të këtij ligji.

4. Autoriteti publikon në faqen zyrtare të tij listën e përmendur në nenin 7 të këtij ligji.

5. Autoriteti brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji nxjerr një listë të standardeve të referencës dhe, kur është e nevojshme, përcakton specifikimet dhe procedurat për masat e përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian.

## **Neni 11**

### **Ndërveprimi ndërkufitar i Portofolëve të Identitetit Digjital**

1. Kur kërkohet identifikim dhe vërtetim elektronik për të aksesuar një shërbim online të ofruar nga një organ i sektorit publik, pranohen gjithashtu edhe Portofolet e Identitetit Digjital që ofrohen në përputhje me përcaktimet e këtij ligji

2. Kur palëve e përfshira private që ofrojnë shërbime, me përjashtim të mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, u kërkohet nga ligji të përdorin autentifikim të përdoruesit për identifikimin online ose kur kërkohet autentifikim i nivelit të lartë të përdoruesit për identifikimin online nga detyrimi kontraktual, duke përfshirë fushat e transportit, energjisë, bankave, shërbimeve financiare, sigurimeve shoqërore, shëndetësisë, ujit të pijshëm, shërbimeve postare, infrastrukturës digjitale, arsimit ose telekomunikacionit, këto palë të përfshira private, jo më vonë se 36 muaj nga data e hyrjes në fuqi të akteve të përmendura në nenin 6 dhe nenin 8 pika 6 dhe vetëm me kërkesën vullnetare të përdoruesit zbatojnë Portofolet e identitetit digjital që ofrohen në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

3. Kur ofruesit e platformave online të mëdha kërkojnë vërtetimin e përdoruesit për akses në shërbimet online, ata gjithashtu pranojnë dhe lehtësojnë përdorimin e Portofoleve të Identitetit Digjital që ofrohen në përputhje me përcaktimet e këtij ligji për autentifikimin e përdoruesit vetëm me kërkesë vullnetare të përdoruesit dhe lidhur me të dhënat minimale të nevojshme për shërbimin specifik online për të cilin kërkohet autentifikimi.

5. Brenda 24 muajve pas vendosjes së Portofoleve të Identitetit Digjital, Autoriteti bën një vlerësim të kërkesave, disponimit dhe përdorimit të Portofoleve të Identitetit Digjital, duke marrë parasysh kritere të tilla si pranimi i përdoruesit, prania ndërkufitare e ofruesit e shërbimeve, zhvillimet teknologjike, evolucioni në modelet e përdorimit dhe kërkesa e konsumatorëve.

[Type here]

## **KREU II**

### **IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK**

#### **Neni 12**

##### **Njohja reciproke**

1. Skemat e identifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara, njihen dhe zbatohen në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, për pranimin e tyre dhe shkëmbimin e të dhënave në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara, të cilët operojnë në vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe janë të akredituar nga Autoriteti mbikëqyrës përkatës, identifikimet dhe shërbimet e besuara të lëshuara prej tyre, kanë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese, si ato të lëshuara nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, që operon në Republikën e Shqipërisë.
3. Për qëllim të pikës 1, njohja reciproke plotëson kushtet e mëposhtme:
  - a) mjeti i identifikimit elektronik lëshohet sipas një skeme identifikimi elektronik që përfshihet në listën e publikuar nga autoritetet përkatëse të shteteve.
  - b) niveli i sigurisë së mjetit të identifikimit elektronik korrespondon me një nivel sigurie të barabartë ose më të lartë se niveli i sigurisë që kërkohet nga organi përkatës i sektorit publik për të aksesuar atë shërbim online në shtetin tjetër, me kusht që niveli i sigurisë së atij mjeti identifikimi elektronik të korrespondojë me një nivel të konsiderueshëm ose të lartë sigurie;
  - c) organi përkatës i sektorit publik përdor nivelin e sigurisë të konsiderueshëm ose të lartë në lidhje me aksesin në atë shërbim online.
2. Një mjet identifikimi elektronik që lëshohet sipas një skeme identifikimi elektronik të përfshirë në listën e publikuar nga autoritetet përgjegjëse/ Komisioni Evropian dhe që korrespondon me nivelin e ulët të sigurisë mund të njihet nga organet e sektorit publik për qëllime të autentifikimit ndërkufitar për shërbimin e ofruar online nga këto organe.

#### **Neni 13**

##### **Njoftimi skemave të identifikimit elektronik**

1. Një skemë identifikimi elektronik do të jetë e ligjshme për njoftim sipas nenit 15 pika 1, me kusht plotësimin e kërkesave të mëposhtme:
  - a) mjetet e identifikimit elektronik nën skemën e identifikimit elektronik mund të përdoren për të hyrë të paktën në një shërbim elektronik të ofruar nga një organ i sektorit publik, që kërkon identifikim elektronik;
  - b) skema e identifikimit elektronik dhe mjetet e identifikimit elektronik të lëshuara sipas kësaj skeme, duhet të përmbushin kushtet për nivelin më të lartë të sigurisë sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;

[Type here]

c) skema e identifikimit elektronik e publikuar, siguron që të dhënat e identifikimit personal të përfaqësojnë në mënyrë unike një person fizik ose juridik, në përputhje me specifikimet teknike, standardet dhe procedurat sipas nivelit të sigurimit të përcaktuar në nenin 14, në momentin e lëshimit të mjetit të identifikimit elektronik;

ç) pala që lëshon mjetet e identifikimit elektronik sipas kësaj skeme siguron të dhëna identifikuese brenda mjeteve të identifikimit elektronik që korrespondojnë me personin të cilit i janë lëshuar mjetet;

d) të sigurojë disponueshmërinë e autentifikimit online, në mënyrë që çdo palë e përfshirë të jetë në gjendje të konfirmojë të dhënat e identitetit të personit, të marra në formë elektronike;

2. Për palët e përfshira, përveç organeve të sektorit publik, duhet të përcaktohen kushtet e aksesit për autentifikim. Mbi këto palë nuk duhet të imponohen kërkesa specifike teknike jo proporcionale të cilat parandalojnë ose pengojnë në mënyrë të konsiderueshme ndërveprimin e skemave të identifikimit elektronik.

3. Autentifikimi ndër-kufitar sigurohet pa pagesë kur përdoret për një shërbim elektronik të ofruar nga një organ i sektorit publik.

## **Neni 14**

### **Nivelet e sigurisë së skemave të identifikimit elektronik**

1. Skema e identifikimit elektronik sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji do të sigurojë nivelet e sigurisë të ulët, konsiderueshëm dhe/ose të lartë për mjetet e identifikimit elektronik të lëshuara sipas skeme.

2. Nivelet e sigurisë të ulët, konsiderueshëm dhe të lartë plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) niveli i ulët i sigurisë, i referohet një mjeti identifikimi elektronik në kontekstin e një skeme identifikimi elektronik, i cili siguron një shkallë të kufizuar të besueshmërisë në identitetin e pretenduar ose të pohuar të një personi dhe karakterizohet duke iu referuar specifikimeve teknike, standardeve dhe procedurave që lidhen me to, duke përfshirë kontrollet teknike, qëllimi i të cilave është zvogëlimi i rrezikut të keqpërdorimit ose ndryshimit të identitetit;

b) niveli i sigurisë i konsiderueshëm i referohet një mjeti identifikimi elektronik në kontekstin e një skeme identifikimi elektronik, i cili siguron një shkallë të konsiderueshme besueshmërie në identitetin e pretenduar ose të pohuar të një personi dhe karakterizohet duke iu referuar specifikimeve teknike, standardeve dhe procedurave që lidhen me to, duke përfshirë kontrollet teknike, qëllimi i të cilave është të ulin ndjeshëm rrezikun e keqpërdorimit ose ndryshimit të identitetit;

c) niveli i lartë i sigurisë i referohet një mjeti identifikimi elektronik në kontekstin e një skeme identifikimi elektronik, i cili siguron një shkallë më të lartë besueshmërie në identitetin e pretenduar ose të pohuar të një personi sesa mjetet e identifikimit elektronik me nivelin e konsiderueshme të sigurisë, dhe karakterizohet duke i referuar specifikimeve teknike, standardeve dhe procedurave që lidhen me to, duke përfshirë kontrollet teknike, qëllimi i të cilave është të parandalojnë keqpërdorimin ose ndryshimin e identitetit.

[Type here]



3. Autoriteti përcakton specifikimet minimale teknike, standardet dhe procedurat në lidhje me të cilat nivelet e sigurisë të ulëta, të konsiderueshëm dhe të larta janë specifikuar për mjetet elektronike të identifikimit elektronik duke marrë në konsideratë elementet e mëposhtëm:

- a) procedurën për të vërtetuar dhe verifikuar identitetin e personave fizikë ose juridikë që aplikojnë për lëshimin e mjeteve identifikimit elektronik;
- b) procedurën për lëshimin e mjetit të identifikimit elektronik të kërkuar;
- c) mekanizmin e autentifikimit, nëpërmjet të cilit personi fizik ose juridik përdor mjetet e identifikimit elektronik për të konfirmuar identitetin e tij tek një palë e përfshirë;
- d) subjekti që lëshon mjetin e identifikimit elektronik;
- e) çdo organ tjetër të përfshirë në aplikimin për lëshimin e mjeteve të identifikimit elektronike; dhe
- f) specifikimet teknike dhe të sigurisë të mjeteve të identifikimit elektronik të lëshuara.

## **Neni 15**

### **Njoftim**

1. Autoriteti publikon në faqen zyrtare skemat e identifikimit elektronik me informacionin si vijon:

- a) një përshkrim të skemës së identifikimit elektronik, duke përfshirë nivelet e sigurisë dhe lëshuesin e mjeteve të identifikimit elektronik sipas skemës;
- b) institucionin përgjegjës dhe mbikëqyrës si dhe informacionin në lidhje me fushën e përgjegjësisë si më poshtë vijon:
  - i) palën që lëshon mjetin elektronik të identifikimit; dhe
  - ii) palën që operon procedurën e autentifikimit;
- d) subjektin ose subjektet që menaxhojnë regjistrimin e të dhënave unike të identifikimit të personit;
- e) një përshkrim mbi përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në nenin 19 të këtij ligji;
- f) një përshkrim të autentifikimit të përmendur në shkronjën f) të nenit 13 të këtij ligji;
- g) përcaktimet mbi pezullimin ose anulimin eskemës së identifikimit elektronik ose të autentifikimit ose të pjesëve të komprometuara

2. Autoriteti në rast ndryshimesh të ndodhura në skemat apo informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni ben përditesimin e tij sa here që është e nevojshme.

3. Autoriteti përcakton formatin e publikimit të informacionit mbi skemën e identifikimit elektronik sipas pikës 1 të këtij neni.

## **Neni 16**

### **Shkeljet e sigurisë në skemat e identifikimit elektronik**

1. Kur skema e identifikimit elektronik sipas përcaktimeve të nenit 15 pika 1 të këtij ligji ose autentifikimi i përmendur në shkronja f) të nenit 13 të këtij ligji është shkelur ose komprometuar pjesërisht në një mënyrë që ndikon në besueshmërinë e autentifikimit të skemës, Autoriteti pezullon ose revokojë pa vonesë atë autentifikim ose pjesët e komprometuara të skemës.

2. Kur shkelja ose kompromentimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni korrigjohet, Autoriteti rikthen skemën dhe autentifikimin sipas asaj skeme.

[Type here]

3. Nëse shkelja ose kompromentimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk korrigjohet brenda tre muajve nga pezullimi ose revokimi, Autoriteti njofton tërheqjen e skemës së identifikimit elektronik.

## **Neni 17**

### **Përgjegjësia**

1. Republika e Shqipërisë si shtet njoftues do të jetë përgjegjës për dëmin e shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia çdo personi fizik ose juridik për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve të tij sipas shkronjave “d” dhe “f” të nenit 13 të këtij ligji në një transaksion ndërkufitar.
2. Pala që lëshon mjetin elektronik të identifikimit do të jetë përgjegjëse për dëmin e shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia çdo personi fizik ose juridik për shkak të mospërmbushjes së detyrimit të përmendur në shkronjën “e” të nenit 13 të këtij ligji.
3. Pala që operon procedurën e autentifikimit do të jetë përgjegjëse për dëmin e shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia çdo personi fizik ose juridik për shkak të dështimit për të siguruar funksionimin e saktë të vërtetimit të përmendur në shkronjën “f” të nenit 13 të këtij ligji.

## **Neni 18**

### **Përputhja e identitetit ndërkufitar**

1. Kur pala e përfshirë vepron si ofrues për shërbimet ndërkufitare, duhet të sigurojë një përputhje të qartë të identitetit për personat fizikë që përdorin mjete identifikimi elektronik ose Portofole të Identitetit Digjital.
2. Autoriteti përcakton masa teknike dhe organizative për të siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje të të dhënave personale të përdorura për përputhjen e identitetit dhe për të parandaluar profilizimin e përdoruesve.
3. Autoriteti do të nxjerrë një listë të standardeve të referencës si dhe do të përcaktojë specifikimet, procedurat për kërkësat të përmendura në pikën 1 të këtij neni, në përputhje me përcaktimet e BE-së.

## **Neni 19**

### **Ndërveprimi**

1. Në rastin e njohjes reciproke skema kombëtare të identifikimit elektronik ndërvepron me skemat e tjera.
2. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, do të krijohet një kuadër ndërveprimi.
3. Kuadri i ndërveprimit plotëson kriteret e mëposhtme:
  - a) synon të jetë neutral ndaj teknologjisë së përdorur dhe nuk bën dallime mes zgjidhjeve specifike teknike kombetare për identifikimin elektronik;
  - b) ndjek standardet evropiane dhe ndërkombëtare, për aq sa është e mundur;

[Type here]

c) lehtëson zbatimin e privatësisë dhe sigurisë që në projektim.

4. Kuadri i ndërveprimit përbëhet nga:

a) një referencë për kërkesat minimale teknike në lidhje me nivelet e sigurisë sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji;

b) një kornizë të niveleve kombëtare të sigurisë së skemave të identifikimit elektronik sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji;

c) një referencë për kërkesat minimale teknike për ndërveprim;

d) një referencë për një grup minimal të të dhënave të nevojshme për identifikimin e personit për të përfaqësuar në mënyrë unike një person fizik ose juridik, ose një person fizik që përfaqëson një person tjetër fizik ose një person juridik, të cilat janë të aksesueshme nëpërmjet skemave të identifikimit elektronik;

e) rregullat e procedurës;

f) mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

g) standardet e përbashkëta të sigurisë operacionale.

5. Autoriteti 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji miraton akte zbatuese për kuadrin e ndërveprimit sipas përcaktimeve në pikën 4 të këtij neni.

## **KREU II**

### **Neni 20**

#### **Certifikimi i skemave të identifikimit elektronik**

1. Konformiteti i skemave të identifikimit elektronik duhet të jetë në përputhje me kërkesat e sigurisë kibernetike të përcaktuara në këtë ligj, përfshirë kërkesat përkatëse të sigurisë kibernetike të përcaktuara në nenin 14, pika 2 të këtij ligji në lidhje me nivelet e sigurisë së skemave të identifikimit elektronik, certifikohen nga organet e vlerësimit të konformitetit të të akredituara në RSH ose vendet anëtare të BE-së.

2. Certifikimi sipas pikës 1 të këtij neni do të kryhet në bazë të skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike, për aq sa certifikata e sigurisë kibernetike ose pjesë të saj mbulojnë këto kërkesa të sigurisë kibernetike.

3. Certifikimi në baze të pikës 1 të këtij neni është i vlefshëm deri në pesë vjet, me kusht që një vlerësim i vulnerabilitetit të kryhet çdo dy vjet. Kur një vulnerabilitet identifikohet dhe nuk korrigjohet brenda tre muajve nga një identifikim i tillë, certifikimi anulohet.

4. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni Autoriteti mund të kërkojë informacione shtesë nga autoriteti përgjegjës njoftues i skemave të identifikimit elektronik ose një pjesë të tyre të certifikuar.

## **KREU III**

### **SHËRBIMET E BESUARA**

#### **SEKSIONI 1**

[Type here]

## **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Neni 21**

#### **Përgjegjësia dhe barra e provës**

1. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni dhe pa rënë ndesh me përcatimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, ofruesit e shërbimeve të besuara janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar me ose pa qëllim ndaj çdo personi fizik ose juridik për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve sipas përcaktimeve të këtij ligji. Çdo person fizik ose juridik i cili ka pësuar dëme materiale ose jomateriale si rezultat i shkeljeve të përcaktimeve të bëra në këtë ligj nga ofruesi i shërbimit të besuar, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim në përputhje me përcatimet e legjislacionit në fuqi.

Barra e provës për të vërtetuar me dashje apo pakujdesinë për dëmin e shkaktuar nga një ofrues i pakualifikuar i shërbimit të besuar i ngarkohet personit fizik ose juridik që pretendon dëmin e përmendur më lart.

Me dashje apo pakujdesia e një ofruesi të kualifikuar të shërbimit të besuar prezumohet në të gjitha rastet me përjashtim kur ai ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar provon se dëmi i përmendur si më lart ka ndodhur pa fajin e tij.

2. Ofruesit e shërbimeve të besuara informojnë paraprakisht me shkrim klientët e tyre lidhur me kufizimet e përdorimit të shërbimeve që ofrojnë, edhe kur këto kufizime janë të njohura gjithashtu nga palë të treta, ofruesit e shërbimeve të besuara nuk mbajnë përgjegjësi për dëmet që rrjedhin nga përdorimi i shërbimeve që tejkalojnë kufizimet e bëra të njohura.

3. Përcatimet e bëra në pikat 1 dhe 2 të këtij neni do të zbatohen në përputhje me përcatimet në legjislacionin kombëtar në fuqi që lidhen me përgjegjësinë e dëmit kontraktor.

### **Neni 22**

#### **Shërbimet e besuara në aspekt me ndërkombëtarët**

1. Shërbimet e besuara të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të besuara të vendosur në një vend të tretë ose nga një organizatë ndërkombëtare njihen si ligjërisht ekuivalente me shërbimet e besuara të kualifikuara të ofruara nga ofrues të kualifikuar të shërbimeve të besuara të vendosura në BE, ku shërbimet e besuara me origjinë nga vendi i tretë ose nga organizatat ndërkombëtare njihen me anë të akteve nënligjore ose një marrëveshjeje të lidhur ndërmjet BE-së dhe vendit të tretë ose organizatës ndërkombëtare. Shërbimet e besuara të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të besuara që operojnë në shtetet jashtë Bashkimit Evropian apo të ofruara nga një organizatë ndërkombëtare do të kenë të njëjtën vlefshmëri ligjore me shërbimet e besuara të ofruara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara të themeluar në Republikën e Shqipërisë, nëse shërbimet e besuara që burojnë nga shteti jashtë BE-së ose organizata ndërkombëtare njihen nëpërmjet marrëveshjeve të ratifikuara midis Republikës së Shqipërisë dhe vendit të tretë ose organizatës ndërkombëtare në përputhje me legjislacionin shqiptar.

[Type here]

2. Aktet nëligjore dhe marrëveshja e përmendur në pikën 1 të këtij neni sigurojnë që kërkesat e zbatueshme për ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar të vendosura në BE dhe shërbimet e kualifikuara të besuara që ata ofrojnë përmbushen nga ofruesit e shërbimeve të besuara në vendin e tretë ose nga organizata ndërkombëtare. Vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare në veçanti krijojnë, mbajnë dhe publikojnë një listë të besuar të ofruesve të njohur të shërbimeve të besuara. Marrëveshja sipas pikës 1 të këtij neni siguron që kërkesat e zbatueshme për OKSHB- të që operojnë/të themeluar në RSH dhe shërbimet e besuara të kualifikuara që ata ofrojnë të përmbushen edhe nga ofruesit e shërbimeve të besuara në shtetet jashtë BE-së apo nga organizata ndërkombëtare dhe shërbimet që ata ofrojnë. Shtetet jo anëtare të BE-së dhe organizatat ndërkombëtare, në veçanti, krijojnë, mbajnë dhe publikojnë një listë të besuar të ofruesve të shërbimeve të besuara të njohur.

3. Marrëveshja e përmendur në pikën 1 të këtij neni siguron që shërbimet e besuara të kualifikuara të ofruara nga ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuara që operojnë në Republikën e Shqipërisë njihen ligjërisht ekuivalente me shërbimet e besuara të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të besuara në shtetin jashtë BE ose nga organizata ndërkombëtare me të cilën është lidhur marrëveshja.

### **Neni 23**

#### **Akresi për personat me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta**

Përdorimi i mjeteve të identifikimit elektronik, shërbimeve të besuara dhe produkteve të përdoruesit fundor që përdoren në ofrimin e këtyre shërbimeve vihen në dispozicion në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuara ashtu edhe për personat me aftësi të kufizuara, si të moshuarit dhe personat me akses të kufizuar në teknologjitë digjitale.

### **Neni 24**

#### **Kundërvajtjet**

Shkeljet e mëposhtme kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Me gjobë 2 milion lekë shkeljet e mëposhtme:

a) kur Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar nuk njofton për fillimin e veprimtarisë, sipas nenit 28 të këtij ligji;

b) kur Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar nuk ndërmarrin masat e nevojshme teknike dhe organizative për menaxhimin e riskut, sipas pikës 1, të nenit 25, të këtij ligji;

c) kur Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar nuk informon Autoritetin dhe përdoruesit e shërbimeve të besuara, mbi shkeljet e sigurisë ose humbjes të integritetit sipas pikës 2, të nenit 25, të këtij ligji;

ç) kur nuk është ruajtur informacioni përkatës pas ndërprerjes së veprimtarisë së ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar, sipas përcaktimeve të nenit 31 pika 4 shkrona “j”, të këtij ligji;

[Type here]

d) kur nuk është realizuar vlerësimi i konformitetit, sipas përcaktimeve të nenit 27 pika 1, të këtij ligji;

e) kur nuk përmbushen kërkesat për pajisjet e krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara të përcaktuara në nenin 36, të këtij ligji.

2. Me gjobë 1 milion lekë shkeljet e mëposhtme:

a) kur nuk plotësohen kushtet për ushtrimin e veprimtarisë si Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, sipas nenit 28, të këtij ligji;

## SEKSIONI 2

### SHËRBIME TE BESUARA JO TË KUALIFIKUARA

#### Neni 25

#### **Kërkesat e sigurisë për tu përmbushur nga ofruesit e shërbimeve të besuara**

1. Ofruesit e shërbimeve të besuara të kualifikuar dhe jo të kualifikuar marrin masat e duhura teknike dhe organizative për menaxhimin e risqeve që prekin sigurinë dhe besueshmërinë e shërbimeve të besuara që ata ofrojnë. Duke marrë parasysh zhvillimet më të fundit teknologjike, këto masa sigurojnë që niveli i sigurisë është në përpjesëtim me shkallën e riskut. Në veçanti, të marrin masa për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin e incidenteve të sigurisë si dhe për informimin e paleve të interesuara/prekura mbi efektet e shkaktuara nga incidente të tilla.

2. Pa vonese, në çdo rast brenda 24 orëve nga marrja në dijeni, sipas pikës 1 të këtij neni, Ofruesit e kualifikuar dhe jo të kualifikuar të shërbimeve të besuara, njoftojnë Autoritetin dhe kur është e nevojshme autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo shkelje të sigurisë ose humbje të integritetit që ka një ndikim të rëndësishëm në shërbimin e besuar të ofruar ose në të dhënat personale.

Kur shkelja e sigurisë ose humbja e integritetit ka një ndikim negativ në një person fizik ose juridik të cilit i është ofruar shërbimi i besuar, ofruesi i shërbimit të besuar njofton pa vonese këto të fundit mbi shkeljen e sigurisë ose humbjen e integritetit.

Nëse një shkelje e sigurisë ose humbja e integritetit ka të bëjë me dy ose më shumë Shtete, Autoriteti informon autoritetet mbikëqyrëse në shtetet e tjera respektive dhe ENISA.

Autoriteti mbikëqyrës informon publikun ose i kërkon ofruesit të shërbimit të besuar për ta bërë këto, kur vendos se publikimi i informacionit të shkeljes së sigurisë ose humbja e integritetit është në interes të publikut.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe çdo vit pas hyrjes në fuqi të tij autoriteti i dërgon pranë ENISA-s një përmbledhje të njoftimeve për shkeljen e sigurisë dhe humbjen e integritetit të marra nga ofruesit e shërbimeve të besuara.

4. Masat për parandalimin dhe minimizimin e ndikimit të incidenteve të sigurisë, si dhe forma, procedurat, afati i reportimit të shkeljeve të sigurisë aplikohen në zbatim të legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike.

[Type here]

## Neni 26

### Kërkesat për ofruesit jo të kualifikuar të shërbimit të besuar

1. Një ofrues i jo i kualifikuar i shërbimit të besuar që ofron shërbime të besuara jo të kualifikuara duhet:

a) të ketë politika të përshtatshme dhe të marrë masat përkatëse për të menaxhuar risqet ligjore, të biznesit, operacionale dhe risqet e tjera të drejtpërdrejta ose të tërthorta në ofrimin e shërbimit të besuar jo të kualifikuar, e cila pavarësisht përcaktimeve të nenit i 21 të Ligjit 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, përfshin të paktën masa në lidhje me:

i) procedurat e prezantimit dhe regjistrimit të një shërbimi të besuar;

ii) kontrollet procedurale ose administrative të nevojshme për të ofruar shërbime të besuara;

iii) menaxhimin dhe zbatimin e shërbimeve të besuara;

b) të njoftoje menjherë dhe jo më vonë se 24 orë kur merr dijeni për çdo shkelje apo ndërprerje të sigurisë, Autoritetin, individët e prekur, publikun, nëse është në interesin e publikut dhe autoritetet e tjera kompetente përkatëse, për çdo shkelje të sigurisë ose ndërprerje në ofrimin e shërbimit ose zbatimin e masave të përmendura në shkronjen (a) pikat (i), (ii) ose (iii) të këtij neni, që kanë një ndikim të rëndësishëm në ofrimin e shërbimit të besuar ose në të dhënat personale. .

2. Autoriteti përcakton me akt nënligjor një listë reference të standardeve, specifikimeve, procedurat sipas pikës 1 të këtij neni, në përputhje me përcaktimet e nxjerra nga BE.

## SEKSIONI 3

### SHËRBIME TË KUALIFIKUARA TË BESUARA

## Neni 27

### Mbikëqyrja e ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar

1. Ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar kontrollohen me shpenzimet e tyre të paktën çdo 24 muaj nga një organ i vlerësimit të konformitetit. Kontrolli kryhet për të konfirmuar se ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar dhe shërbimet e kualifikuara të besuara të ofruara prej tyre përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë ligj si dhe përcaktimeve në lidhje me menaxhimin e riskut sipas legjislacionit në fuqi për sigrinë kibernetike. Ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar paraqesin raportin e vlerësimit të konformitetit pranë autoritetit brenda tre ditëve pune pas marrjes së tij nga Organi i leresimit të Konformitetit.

2. Ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar informon Autoritetin, jo më vonë se një muaj për çdo kontroll të planifikuar sipas pikës 1 të këtij neni, duke e lejuar autoritetin të marrë pjesë në statusin e vëzhguesit me kërkesë të tij.

[Type here]

3. Autoriteti publikon në faqen zyrtare të tij listën me, emrat, adresat dhe detajet e akreditimit të organeve të vlerësimit të konformitetit të përmendura në pikën 1 të këtij neni si dhe çdo ndryshim të mëvonshëm të tyre.

4. Pavarisht parashikimeve në pikën 1 të këtij neni, Autoriteti në çdo kohë mund të kryej kontroll ose t'i kërkojë një organi të vlerësimit të konformitetit të kryejë një vlerësim të konformitetit të ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar, me shpenzimet e këtyre ofruesve të kualifikuar dhe jo të kualifikuar të shërbimit të besuar, për të konfirmuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në këtë ligj. Kur Autoriteti konstaton shkeljen e rregullave të mbrojtjes së të dhënave personale, ai njofton autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale për rezultatet e kontrolleve të tij.

5. Kur autoriteti konstaton parregullsi në veprimtarinë e ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar, rekomandon korigjimin e tyre brenda një afati të caktuar kohor, në përmbushjen e kërkesave të këtij ligji.

Kur ofruesi nuk përmbush zbatimin e rekomandimeve brenda afatit kohor të përcaktuar nga autoriteti ky i fundit vendos për heqjen e statusit të kualifikuar për këto ofrues ose shërbimet e ofruara prej tij.

6. Autoriteti si organi përgjegjës për sigurinë kibernetike kur konstaton se OKSHB nuk përmbush kërkesat e përcaktuara lidhur me masat e menaxhimit të riskut sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike, ky i fundit kur është e justifikuar shtrirja, kohëzgjatja dhe pasojat e atij dëmi, tërheq statusin e kualifikuar ofruesit të shërbimit të besuar, ose të shërbimit të ofruar prej tij.

7. Kur Autoriteti informohet nga autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale se ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, kur justifikohet shtrirja, kohëzgjatja dhe pasojat e demit të ardhur, Autoriteti tërheq statusin e kualifikuar ofruesit ose shërbimit të ofruar prej tij.

8. Autoriteti informon ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar për tërheqjen e statusit të kualifikuar ose të statusit të shërbimit të kualifikuar të ofruar prej tij, si dhe perditeson listën e besuar .

9. Autoriteti brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi të akteve të nxjerra nga Komisioni Evropian do të nxjerr një listë referencë të standardeve dhe, kur është e nevojshme, do të përcaktojë specifikimet dhe procedurat për sa vijon:

a) akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe për raportin e vlerësimit të konformitetit të përmendur në pikën 1 të këtij neni;

b) kërkesat e auditimit për organet e vlerësimit të konformitetit për të kryer vlerësimin e tyre të konformitetit, duke përfshirë vlerësimin e përbërë, të ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar, sipas pikës 1 të këtij neni;

c) skemat e vlerësimit të konformitetit për kryerjen e vlerësimit të konformitetit të ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar nga organet e vlerësimit të konformitetit dhe për dhënien e raportit sipas pikës 1 të këtij neni.

## Neni 28

[Type here]



## **Fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar**

1. Ofruesit e shërbimeve të besuar të cilët nuk kanë marrë statusin i kualifikuar dhe synojnë të ofrojnë shërbime të kualifikuara të besuara, brenda 7 diteve nga fillimi i ushtrimit të aktivitetit, paraqet prane autoritetit nje kerkese te shoqeruar me dokumentacionin perkates perfshire edhe raportin e vleresimit të konformitetit të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i cili konfirmon përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në këtë ligj si dhe kërkesat lidhur me menaxhimin e riskut sipas legjialscionit në fuqi për sigurinë kibernetike.

2. Autoriteti verifikon nëse ofruesi i shërbimit të besuar dhe shërbimet e besuara të ofruara prej tij përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe, në veçanti me kërkesat për ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar dhe për shërbimet e kualifikuara të besuar që ata ofrojnë.

Autoriteti si organ përgjegjes për sigurinë kibernetike, kontrollon përmbushjen e kërkesave të ofruesit të shërbimit të besuar lidhur me masat e menaxhimit të riskut sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sigurinë kibernetike si dhe harton një raport me rezultatin brenda dy muajve.

Nëse Autoriteti konstaton se ofruesi i shërbimit të besuar dhe shërbimet e besuar të ofruara prej tij përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, jo më vonë se 3 muaj nga marrja e kërksës nga OSHB, i jep statusin i kualifikuar ofruesit të shërbimit të besuar dhe shërbimeve të besuara të ofruara prej tij si dhe përditeson listen e besuar.

Nese verifikimi nga Autoriteti nuk është përfunduar brenda tre muajve nga marrja e kërkesës nga OSHB-ja, Autoriteti informon ofruesin e shërbimit të besuar mbi arsyet për vonesën dhe periudhën brenda së cilës duhet të përfundojë verifikimi, e cila nuk mund të kaloj 6 muaj.

3. Ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar fillojnë të ofrojnë shërbime e kualifikuara të besuar, pas përfitimit të statusit i kualifikuar si dhe pas publikimit në listen e besuar.

4. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e akteve të nxjerra nga Komisioni Evropian do të përcaktohen me VKM formatet dhe procedurat e njoftimit dhe verifikimit lidhur me dokumentacionin e OSHB për marrjen e statusit të kualifikuar.

## **Neni 29**

### **Listat e besuara**

1. Autoriteti krijon, mirëmban dhe publikon listën e besuar, që përfshin informacion në lidhje me Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara, si dhe informacion mbi shërbimet e besuara të kualifikuara të ofruara prej tyre, që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë
2. Autoriteti krijon, ruan dhe publikon, në mënyrë të sigurt, listën e besuar të nënshkruar apo të vulosur elektronikisht dhe e publikon atë në faqen zyrtare të tij, sipas përcaktimeve të standardeve të Bashkimit Evropian.
3. Autoritetit i njofton Komisionit, informacionin mbi autoritetin përgjegjës për krijimin, mbajtjen dhe publikimin e listave kombëtare të besuara, dhe detajet se ku publikohen lista të tilla, certifikatat e përdorura për të nënshkruar ose vulosur listat e besuara dhe çdo ndryshim në to.

[Type here]

4. Autoriteti vë në dispozicion të publikut, nëpërmjet një kanali të sigurt, informacionin e përmendur në pikën 3 të këtij neni në formë të nënshkruar ose të vulosur në mënyrë elektronike të përshtatshme për përpunim të automatizuar.
5. Brenda një vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji Autoriteti do të nxjerrë akte nenligjore që do të specifikojë informacionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe do të përcaktojë specifikimet teknike dhe formatet për listat e besuara të zbatueshme për qëllimet e pikave 1 deri në 4 të këtij neni në përputhje me specifikimet teknike dhe formatet e miratuara nga Komisioni Evropian.

### **Neni 30**

#### **Marka e besuara të për shërbimet e kualifikuara të besuara**

1. Pas marrjes së statusit 'të kualifikuar' referuar në pikën 3 të nenit 28, si dhe pas publikimit në listën e besuar të përmendur në nenin 29, ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara mund të përdorin markën e besuar, për të treguar në mënyrë të thjeshtë, të njohur dhe të qartë shërbimet e besuara të kualifikuara që ata ofrojnë.
2. Kur përdoret marka e besuar, për shërbimet e besuara të kualifikuara referuar në pikën 1 të këtij neni, ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara duhet të sigurojnë që në faqen zyrtare të tyre të jetë i disponueshëm një link (lidhje) me listën përkatëse të besuar.
3. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji Autoriteti do të nxjerrë akte nenligjore lidhur me specifikimet e formës, dhe në veçanti paraqitjen, përbërjen, madhësinë dhe dizajnin e markës së besuar të BE-së për shërbimet e kualifikuara të besuara sipas përcaktimeve të nxjerra nga Komisioni Evropian.

### **Neni 31**

#### **Kërkesat për ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar**

1. Nje ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar i cili leshon një certificate të kualifikuar ose një vërtetim elektronik të kualifikuar të attributeve, verifikon identitetin dhe, çdo atribut specifik të personit fizik ose juridik të cilit i është lëshuar certifikata e kualifikuar ose vërtetimi elektronik i kualifikuar i attributeve.
2. Verifikimi i identitetit sipas pikën 1 të këtij neni kryhet me mjetet e duhura, nga ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar, drejtpërdrejt ose nga një pale e tretë, duke u bazuar në nje prej metodave të mëposhtme ose, në një kombinim të tyre si vijon:
  - a) me anë të portofolit të identitetit digjital ose një mjeti të identifikimit elektronik në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji në lidhur me nivelin e lartë të sigurisë;
  - b) me anë të një certifikate të nënshkrimit elektronik të kualifikuar ose të vules elektronike të kualifikuar, të lëshuar në përputhje me shkronjat (a), (c) ose (d) të kësaj pike;
  - c) duke përdorur metoda të tjera identifikimi që sigurojnë identifikimin e personit me nivelin më të lartë të sigurisë, konformiteti i të cilit konfirmohet nga një organ i vlerësimit të konformitetit;

[Type here]

d) nëpërmjet pranisë fizike të personit fizik ose të një përfaqësuesi të autorizuar të personit juridik, nepermjet autorizimit dhe procedurave të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

3. Verifikimi itributeve të përmendura në pikën 1 do të kryhet, me mjetet e duhura, nga ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar, drejtpërdrejt ose me anë të një pale të tretë, në bazë të njërës prej metodave të mëposhtme ose, kur është e nevojshme, në një kombinim i tyre si vijon:

- a) me anë të portofolit të identitetit digjital ose një mjeti të identifikimit elektronik në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji lidhur me nivelin e lartë të sigurisë;
- b) me anë të një certifikate të nënshkrimit elektronik të kualifikuar ose të vules elektronike të kualifikuar, të lëshuar në përputhje me shkronjat “a”, “c” ose “d” të kësaj pikë;
- c) me anë të një vërtetimi elektronik të kualifikuar tëtributeve;
- d) duke përdorur metoda të tjera, të cilat sigurojnë verifikimin etributeve me një nivel të lartë të sigurisë, konformiteti i të cilave konfirmohet nga një organ i vlerësimit të konformitetit;
- e) me anë të pranisë fizike të personit fizik ose të një përfaqësuesi të autorizuar të personit juridik, me anë të autorizimit dhe procedurave të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

3. Autoriteti, me anë të akteve nënligjore, do të krijojë një listë reference të standardeve dhe, kur është e nevojshme, do të përcaktojë specifikimet dhe procedurat për verifikimin e identitetit dhetributeve në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni brenda 24 muajve nga nxjerrja e këtyre akteve nënligjore nga Komisioni Evropian.

4. Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar duhet:

- a) të informojë Autoritetin brenda një muaji për çdo ndryshim në ofrimin e shërbimeve të kualifikuara të besuara ose brenda tre muajve në rast të ndërprerjes së veprimtarisë ;
- b) të punësojë staf dhe, kur është e zbatueshme, nënkontraktorë të cilët zotërojnë ekspertizë, besueshmëri, përvojë dhe kualifikimet e nevojshme dhe kanë marrë trajnimet e duhura mbi ceshtjet e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe zbaton procedurat administrative dhe menaxhuese të cilat korrespondojnë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare;
- c) të zotërojë burimet e nevojshme financiare për dëmshpërblimet e mundshme sipas nenit 21 të këtij ligji.
- d) para se të hyjë në një marrëdhënie kontraktuale, të informojë, në një mënyrë të qartë dhe të plotë çdo person që kërkon të përdorë shërbimin e kualifikuar të besuar mbi termat dhe kushtet përdorimit si dhe çdo kufizim në përdorimin e këtij shërbimi;
- e) të përdorë sisteme dhe produkte të sigurta që janë të mbrojtura ndaj modifikimit dhe që garantojnë sigurinë teknike dhe besueshmërinë e proceseve të mbështetura nga ana e tyre,
- f) të përdorë sisteme të sigurta për të ruajtur të dhënat të cilat :
  - i) mund të vendosen në dispozicion të publikut vetëm me pëlqimin e personit të të cilit i referohen këto të dhënat;
  - ii) ndryshimet apo shenimet në këto të dhëna mund të behen vetëm nga personat e autorizuar

[Type here]

iii) të dhënat mund të kontrollohen për vertetësinë e tyre.

g) pavarësisht nga masat e përkatëse për të menaxhuar risqe ligjore, biznesi, operacionale dhe të tjera të drejtpërdrejta ose të tërthorta për ofrimin e shërbimit të kualifikuar të besuar, përfshihen masat si me poshte:

i) procedurat e regjistrimit dhe hyrjes në një shërbim;

ii) kontrole procedurale ose administrative;

iii) menaxhimi dhe implementimi i shërbimeve;

h) në rast të një incidenti, njofton menjëherë dhe në çdo rast brenda 24 orëve nga momenti i identifikimit të tij, Autoritetin, individët e prekur, organet e tjera kompetente përkatëse dhe, publikun kur është në interes të publikut, për çdo shkelje të sigurisë ose ndërprerje në ofrimin e shërbimit ose zbatimin e masave të përmendura në shkronjat “g” nënndarja “i”, (ii), (iii) të këtij neni që kanë një ndikim të rëndësishëm në ofrimin e shërbimit të besuar ose në të dhënat personale.

i) të marrë masat e duhura kundër falsifikimit, vjedhjes, shpërdorimit, fshirjes, ndryshimit ose bërjes të pa aksesueshme, të dhënave;

j) të regjistrojë dhe të mbajë të aksesueshme për aq kohë sa është e nevojshme pas ndërprerjes së veprimtarisë, të gjithë informacionin përkatës mbi të dhënat e lëshuara dhe të marra nga ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar, me qëllim përdorimin e tyre në procedura ligjore si dhe për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit. Një regjistrerë tillë mbahet në mënyrë elektronike;

k) të ketë një plan të përditësuar për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit në përputhje me përcaktimet e nenit 71 pika 3 shkronja “k”;

l) krijon dhe mban një bazë të përditësuar me të dhënat e certifikatave të kualifikuar të lëshuara.

5. Autoriteti gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për dhënien e statusit të kualifikuar OSHB-së kërkon nga ky i fundit informacion shtesë bazuar edhe në raportin e vlerësimit të konformitetit. Nëse verifikimi nuk është përfunduar brenda tre muajve nga marrja e kërkesës nga OSHB-ja autoriteti informon ofruesin e shërbimit të besuar, mbi arsyet e vonës dhe periudhën brenda së cilës duhet të përfundojë verifikimi e cila nuk mund të kalojë 6 muaj.

6. Nëse një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar që lëshon certifikata të kualifikuara vendos të anulojë një certifikatë, këtë anulim duhet ta regjistrojë në bazën e të dhënave të certifikatave dhe të publikojë statusin e revokimit/anulimit të certifikatës, në çdo rast brenda 24 orëve pas marrjes së kërkesës së zotëruesit. Anulimi hyn në fuqi menjëherë pas publikimit të tij.

7. Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara, i sigurojnë palës së përfshirë çdo informacion mbi statusin e vlefshmërisë së certifikatave të kualifikuara të lëshuara prej tyre. Ky informacion është në dispozicion në çdo kohë, edhe përtej periudhës së vlefshmërisë së certifikatave, në një mënyrë të automatizuar që është e besueshme, pa pagesë dhe efektive.

8. Përcaktimet në pikën 6 dhe 7 të këtij neni do të aplikohen në përputhje me anulimin e vërtetimeve elektronike të kualifikuara të attributeve.

9. Autoriteti, do të nxjerrë akte nënligjore, lidhur me listën e reference të standardeve dhe do të përcaktojë specifikimet dhe procedurat për kërkesat e përmendura në pikën 2 të këtij neni, brenda

[Type here]

24 muajve nga hyrja në fuyqi e këtyre përcaktimeve të nxjerrta nga Komisioni Evropian Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në këtë pikë do të konsiderohen kur këto standarde, specifikime dhe procedura janë përmbushur.

## **SEKSIONI 4 NËNSHKRIMET ELEKTRONIKE**

### **Neni 32**

#### **Efektet ligjore të nënshkrimit elektronik**

1. Nënshkrimi elektronik i kualifikuar ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese si një nënshkrim i bërë dorazi.
2. Nënshkrimi elektronik i kualifikuar është i pavlefshëm, kur vërtetohet se nuk janë përmbushur kërkesat për sigurinë, të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

### **Neni 33**

#### **Kërkesat për nënshkrime elektronike të avancuara**

1. Nënshkrimi elektronik i avancuar duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:
  - a) lidhet në mënyrë unike me nënshkruesin;
  - b) mundëson identifikimin e nënshkruesit;
  - c) është krijuar duke përdorur të dhënat për krijimin e nënshkrimit elektronik, që i përkasin ekskluzivisht nënshkruesit;
  - d) lidhet me të dhënat e nënshkruara në mënyrë të tillë, që të mundësojnë dallimin lehtësisht të çdo ndryshimi të mëpasshëm të këtyre të dhënave.
2. Brenda 12 muaj nga nxjerrja e akteve nënligjore nga KE lidhur me referencat e standardeve, specifikimet dhe procedurat për nënshkrimin elektronik të avancuar, Autoriteti miraton aktet përkatëse sipas përcaktimeve të KE.

### **Neni 34**

#### **Nënshkrimet elektronike në shërbimet publike**

1. Nëse në shërbimet publike elektronike të ofruara nga një organ publik kërkohet përdorimi i një nënshkrimi elektronik të avancuar, organi publik do të njohet nënshkrimet elektronike të avancuara, bazuar në një certifikatë të kualifikuar për nënshkrimet elektronike dhe nënshkrimet elektronike të kualifikuar në formatet e miratuara nga Autoriteti sipas standardeve ndërkombëtare .
2. Nëse në shërbimet publike elektronike të ofruara nga një organ publik kërkohet përdorimi i një nënshkrimi elektronik të avancuar bazuar në një certifikatë të kualifikuar për të përdorur një shërbim online të ofruar nga ose në emër të një organi të sektorit publik organi publik do të njohë

[Type here]

nënshkrimet elektronike të avancuara bazuar në një certifikatë të kualifikuar dhe nënshkrime elektronike të kualifikuara në formatet e miratuar nga autoriteti sipas standardet nderkombetare. Format i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet edhe për përdorim ndërkufitar të një shërbimi publik elektronik të ofruar nga një organ publik.

3. Brenda 6 muajve nga nxjerrja e akteve nenligjore nga KE lidhur me referencat e standardeve, specifikimet dhe procedurat për nënshkrimin elektronik të avancuar, Autoriteti nxjerr aktet perkatëse.

## **Neni 35**

### **Certifikata të kualifikuara për nënshkrime elektronike**

1. Certifikatat e kualifikuara për nënshkrimet elektronike duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në aneksin I të këtij ligji.
2. Certifikatat e kualifikuara për nënshkrimet elektronike nuk i nënshtrohen asnjë kërkesë të detyrueshme që tejkalon kërkesat e përcaktuara në aneksin I ose pikën 1 të këtij neni.
3. Certifikatat e kualifikuara për nënshkrimet elektronike mund të përfshijnëtribute specifike shtesë jo të detyrueshme, të cilat nuk ndikojnë në ndërvëprimin dhe njohjen e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara.
4. Nëse një certifikatë e kualifikuar për nënshkrimet elektronike është anuluar pas aktivizimit fillestar, ajo humbet vlefshmërinë e saj që nga momenti i anulimit dhe statusi i saj nuk do të rikthehet në asnjë rrethanë.
5. Autoriteti përcakton rregullat për pezullimin e përkohshëm të një certifikate të kualifikuar për nënshkrim elektronik në këto raste:
  - a) nëse një certifikatë e kualifikuar për nënshkrim elektronik është pezulluar përkohësisht, ajo certifikatë do të humbasë vlefshmërinë e saj për periudhën e pezullimit;
  - b) periudha e pezullimit duhet të tregohet qartë në bazën e të dhënave të certifikatës dhe statusi i pezullimit duhet të jetë i dukshëm, gjatë periudhës së pezullimit, nga shërbimi që ofron informacion mbi statusin e certifikatës.
6. Brenda 24 muajve nga nxjerrja e akteve nenligjore nga KE lidhur me listën e referencave të standardeve, specifikimet dhe procedurat për nënshkrimet elektronike të kualifikuara Autoriteti do të miratojë aktet nenligjore përkatëse. Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në aneksin I do të konsiderohet kur një certifikatë e kualifikuar për nënshkrimin elektronik përputhet me ato standarde, specifikime dhe procedura.

## **Neni 36**

### **Kërkesat për pajisje për krijimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara**

1. Pajisjet për krijimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në aneksin II të këtij ligji.

[Type here]

2. Gjenerimi ose menaxhimi i të dhënave të krijimit të nënshkrimit elektronik ose dublikimi i të dhënave të krijimit të nënshkrimit për qëllime *backup* do të kryhet vetëm në emër të nënshkruesit, me kërkesë të nënshkruesit dhe nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar që ofron një shërbim të kualifikuar të besuar për menaxhimin e një pajisjeje për krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar në distancë.

3. Autoriteti përcakton referencat dhe standardet për pajisjet për krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar në përputhje me standardet dhe referencat e KE brenda 24 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

### **Neni 37**

#### **Kërkesat për një shërbim të kualifikuar për menaxhimin e pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara në distancë**

1. Menaxhimi i pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara në distancë si një shërbim i kualifikuar do të kryhet vetëm nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar i cili:

- a) gjeneron ose menaxhon të dhënat e krijimit të nënshkrimit elektronik në emër të nënshkruesit;
- b) pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 shkronja d të aneksit II të këtij ligji dublikimi i të dhënave për e krijimin e nënshkrimit elektronik behet vetëm për qëllime backup-i, me kusht që të plotësohen kërkesat e mëposhtme:
  - i) siguria e të dhënave të dublikuara duhet të jetë në të njëjtin nivel sigurie si origjinali i të dhënave;
  - ii) numri i të dhënave të dublikuara nuk duhet të kalojë minimumin e nevojshëm për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit;
- c) përputhet me çdo kërkesë të identifikuar në raportin e certifikimit të pajisjes specifike të krijimit të nënshkrimit elektronik të kualifikuar në distancë, të lëshuar sipas nenit 38.

2. Autoriteti përcakton referencat dhe standardet dhe specifikimet, procedurat qëllimet e pikës 1 të këtij neni sipas përcaktimeve të nxjerra nga KE brenda 24 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

### **Neni 38**

#### **Certifikimi i pajisjeve për krijimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara**

1. Konformiteti i pajisjeve për krijimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara sipas kërkesave të përcaktuara në aneksin II të këtij ligji do të certifikohen nga Organet e Vlerësimit të Konformitetit nga lista e publikuar nga Autoriteti ose Komisioni Evropian.

2. Autoriteti publikon emrat e Organet e Vlerësimit të Konformitetit në faqen zyrtare të tij.

3. Certifikimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni bazohet në pikat si më poshtë:

[Type here]

- a) në një proces vlerësimi të sigurisë i kryer në përputhje me një nga standardet për vlerësimin e sigurisë së produkteve të teknologjisë së informacionit të përfshira në listën e përcaktuar në përputhje me pikën e dytë të këtij neni; ose
- b) në një proces tjetër përveç procesit të përmendur në shkronjen (a) të kësaj pike, me kusht që të përdore nivele të krahasueshme sigurie dhe me kusht që organi publik ose privat i përmendur në pikën 1 të këtij neni të njoftojë Autoritetin . Ky proces mund të përdoret vetëm në mungesë të standardeve të përmendura në shkronjën (a) të kësaj pike ose kur një proces vlerësimi i sigurisë i përmendur në shkronjën (a) të kësaj pike është në proces.

Autoriteti, do të nxjerrë akte nënligjore, për të krijuar një listë standardesh për vlerësimin e sigurisë së produkteve të teknologjisë së informacionit të përmendura në shkronjen a të kësaj pike në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian.

4 . Vlefshmëria e një certifikimi të përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk duhet të kalojë pesë vjet, me kusht që vlerësimet e vulnerabiliteteve të kryhen çdo dy vjet. Kur vulnerabilitetet identifikohen dhe nuk korrigjohen, certifikimi do të anulohet.

5. Kriteret e regjistrimit të OVK sipas pikës 1 të këtij neni përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit.

### **Neni 39**

#### **Publikimi i një liste të pajisjeve të certifikuara të krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara**

1. Brenda 30 ditëve nga përfundimi i procesit të vlerësimit dhe të certifikimit të pajisjeve të krijimit të nënshkrimit elektronik të kualifikuar, OVK vendas ose një i tillë i akredituar në një nga vendet e BE, dorëzon tek Autoriteti raportin e certifikimeve me listën e pajisjeve të krijimit të nënshkrimit elektronik të certifikuara. Gjithashtu organet e vlerësimit kanë detyrimin të njoftojnë Autoritetin mbi përfundimin e afatit të certifikimit të pajisjeve, 3 muaj para përfundimit të këtij afati.
2. Autoriteti krijon, publikon dhe mban në formë elektronike, një listë të pajisjeve të certifikuara për krijimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara, bazuar në raportin e marrë nga organi i certifikimit të pajisjeve të krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara.
3. Brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligj Autoriteti përcakton formatin dhe procedurat e zbatueshme për qëllimet e pikës 1 të këtij neni në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian.

### **Neni 40**

#### **Kërkesat për vërtetimin e vlefshmërisë së nënshkrimeve elektronike të kualifikuara**

1. Procesi për vërtetimin e vlefshmërisë së një nënshkrimi elektronik të kualifikuar do të konfirmojë vlefshmërinë e një nënshkrimi elektronik të kualifikuar si vijon:

[Type here]



- a) mbështetet në një certifikatë të kualifikuar, e cila është e vlefshme në kohën e krijimit të nënshkrimit, në përputhje me kërkesat e aneksit I të këtij ligji;
- b) certifikata e kualifikuar është lëshuar nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar;
- c) të dhënat e vërtetimit të vlefshmërisë së nënshkrimit korrespondojnë me të dhënat e lëshuara të palëve të përfshira;
- ç) grupi unik i të dhënave që përfaqësojnë nënshkruesin në certifikatën elektronike të kualifikuar, i është dhënë saktë palës së përfshirë;
- d) përdorimi i çdo pseudonimi i tregohet qartë palës së përfshirë, në qoftë se është përdorur në kohën e nënshkrimit;
- dh) nënshkrimi elektronik është krijuar nga një pajisje për krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar;
- e) integriteti i të dhënave të nënshkruara nuk është kompromentuar
- h) kërkesat e parashikuara në nenin 33 janë plotësuar në momentin e nënshkrimit.

Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në paragrafin e parë të pikës 1 të këtij neni do të merret në konsideratë kur vërtetimi i nënshkrimeve elektronike të kualifikuara përputhet me standardet, specifikimet dhe procedurat e përmendura në pikën 3.

2. Sistemi i përdorur për vërtetimin e vlefshmërisë së nënshkrimit elektronik të kualifikuar, i siguron palëve të përfshira rezultatin korrekt të procesit të vërtetimit të vlefshmërisë dhe i lejon palëve të përfshira të identifikojnë çdo problematikë të mundshme lidhur me sigurinë.

3. Autoriteti do të nxjerrë akte nënligjore, lidhur me listë reference të standardeve përcaktimin e specifikimeve dhe procedurave për vërtetimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara brenda 24 muajve nga hyra në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian.

## **Neni 41**

### **Kërkesat për vërtetimin e vlefshmërisë së nënshkrimeve elektronike të avancuara bazuar në certifikata të kualifikuara**

1. Procesi për vërtetimin e vlefshmërisë së një nënshkrimi elektronik të avancuar bazuar në një certifikatë të kualifikuar konfirmon vlefshmërinë e një nënshkrimi elektronik të avancuar bazuar në një certifikatë të kualifikuar, duke plotësuar kushtet si me poshtë:

- a) mbështetet në një certifikatë të kualifikuar, e cila është e vlefshme në kohën e krijimit të nënshkrimit, në përputhje me kërkesat e aneksit I të këtij ligji
- b) certifikata e kualifikuar është lëshuar nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar;
- c) të dhënat e vërtetimit të vlefshmërisë së nënshkrimit korrespondojnë me të dhënat e lëshuara të palëve të përfshira;
- d) grupi unik i të dhënave që përfaqësojnë nënshkruesin në certifikatën elektronike të kualifikuar, i është dhënë saktë palës së përfshirë;
- e) përdorimi i çdo pseudonimi i tregohet qartë palës së përfshirë, në qoftë se është përdorur në kohën e nënshkrimit;

[Type here]

- f) nënshkrimi elektronik është krijuar nga një pajisje për krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar;
  - g) e) integriteti i të dhënave të nënshkruara nuk është kompromentuar
  - h) kërkesat e parashikuara në nenin 33 të këtij ligji janë plotësuar në momentin e nënshkrimit.
2. Sistemi i përdorur për vërtetimin e nënshkrimit elektronik të avancuar bazuar në certifikatën e kualifikuar i sigurojë palës së përfshirë rezultatin e saktë të procesit të vlefshmërisë si dhe i lejon asaj të zbulojë çdo çështje të rëndësishme të sigurisë.
3. Autoriteti do të nxjerrë akte nënligjore, lidhur me listë reference të standardeve përcaktimin e specifikimeve dhe procedurave për vërtetimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara brenda 24 muajve nga hyra në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian. Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni do të merret në konsideratë kur vërtetimi i nënshkrimit elektronik të avancuar bazuar në certifikatë të kualifikuara është në përputhje me ato standarde, specifikime dhe procedura.

#### **Neni 42**

##### **Shërbimi i kualifikuar i vërtetimit të vlefshmërisë së nënshkrimeve elektronike të kualifikuara**

1. Shërbimi i kualifikuar i vërtetimit të vlefshmërisë së nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ofrohet vetëm nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, i cili:
- a) siguron procesin e vërtetimit të vlefshmërisë në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 41 të këtij neni ;
  - b) lejon palët e përfshira të marrin rezultatin e procesit të vërtetimit të vlefshmërisë në një mënyrë të automatizuar, i cili është i besueshëm, efikas dhe mban nënshkrimin elektronik ose vulën elektronike të Ofruesit të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar
2. Autoriteti do të nxjerrë akte nënligjore, lidhur me listën e references të standardeve përcaktojnë specifikimet dhe procedurat për shërbimin e kualifikuar të vërtetimit të vlefshmërisë të përmendur në pikën 1 të këtij neni, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e Komisionit Evropian.. Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni do të merret në konsideratë kur shërbimi i kualifikuar i vërtetimit të vlefshmërisë për nënshkrimet elektronike të kualifikuara është në përputhje me ato standarde, specifikime dhe procedura.

#### **Neni 43**

##### **Shërbimi i kualifikuar i ruajtjes së nënshkrimeve elektronike të kualifikuara**

1. Shërbimi i kualifikuar i ruajtjes së nënshkrimeve elektronike të kualifikuara ofrohet vetëm nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar i cili përdor procedurat dhe teknologjitë e nevojshme për të rritur sigurinë e nënshkrimit elektronik të kualifikuar përtej periudhës së vlefshmërisë teknologjike.

[Type here]

2. Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në piken 1 të këtij neni merret në konsideratë kur marrëveshjet për shërbimin e kualifikuar të ruajtjes së nënshkrimeve elektronike të kualifikuara përputhen me standardet, specifikimet dhe procedurat e përmendura në piken 2 të këtij neni.

3. Autoriteti do të nxjerrë akte nënligjore, lidhur me listën e referencave të standardeve, përcaktimin e specifikimeve procedurave për shërbimin e kualifikuar të ruajtjes për nënshkrimet elektronike të kualifikuara brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian.

## **SEKSIONI 5**

### **VULA ELEKTRONIKE**

#### **Neni 44**

#### **Efektet ligjore të vulave elektronike**

1. Vulat elektronike të përdorura në procedurat ligjore konsiderohen të vlefshme pavarësisht formës elektronike të tyre.
2. Integriteti i të dhënave, me të cilat lidhet vula elektronike e kualifikuar dhe saktësia e origjinës së tyre merren si të vërteta.

#### **Neni 45**

#### **Kërkesat për vula elektronike të avancuara**

1. Vula elektronike e avancuar plotëson kërkesat e mëposhtme:
  - a) lidhet në mënyrë unike me krijuesin e vulës;
  - b) identifikon krijuesin e vulës;
  - c) krijohet duke përdorur të dhënat e krijimit të vulës elektronike nën kontrollin e plote të krijuesit të saj, me një nivel të lartë besueshmërie;
  - d) Lidhet me të dhënat të cilave u referohet, në mënyrë të tillë, që çdo ndryshim i mundshëm i tyre të jetë i dallueshëm.
2. Autoriteti do të nxjerrë akte nënligjore, lidhur me listën e referencave të standardeve dhe përcaktimin e specifikimeve dhe procedurave për vulat elektronike të avancuara brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian. Pajtueshmëria me kërkesat për vulat elektronike të avancuara do të merret në konsideratë kur një vulë elektronike e avancuar përputhet me ato standarde, specifikime dhe procedura.

#### **Neni 46**

#### **Vulat elektronike në shërbimet publike**

1. Nëse në shërbimet publike elektronike të ofruar nga një organ publik përdoret një vulë

[Type here]

elektronike e avancuar, ky i fundit do te njohë vulat elektronike të avancuar, vulat elektronike të avancuara bazuar në një certifikatë të kualifikuar, dhe vulat elektronike te kualifikuara te cilat duhet të jetë në formatin e miratuar nga Autoriteti, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2. Nëse në shërbimet publike elektronike të ofruar nga një organ publik përdoret një vulë elektronike e avancuar bazuar ne nje certificate te kualifikuar, ky organ do te njohë vulat elektronike bazuar në një certifikatë të kualifikuar, dhe vulat elektronike te kualifikuara te cilat duhet të jetë në formatin e miratuar nga Autoriteti, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

3. Për përdorim ndërkufitar të një shërbimi publik elektronik të ofruar nga një organ publik, nuk do te kerkohet nje nivel me i larte sigurie por do te zbatohen kriteret sipas pikës 1, të këtij neni

4. Autoriteti nxjerr aktin nënligjor i cili përcakton referencën e vulave elektronike të avancuara ose metodat ku përdoren formatet alternative brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji nëq përputhje me aktetet e nxjerra nga KE.

## **Neni 47**

### **Certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike**

1. Certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike plotësojnë kërkesat e përcaktuara në aneksin III të këtij ligji.

2. Certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike nuk do te kete kërkesa të tjera pervec atyre te përcaktuara në aneksin III të këtij ligji.

3. Certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike mund të përfshijnë attribute specifike shtesë jo detyruese. Këto attribute nuk do të ndikojnë në ndërveprimin dhe njohjen e vulave elektronike të kualifikuara.

4. Nëse një certifikatë e kualifikuar për një vulë elektronike është anuluar pas aktivizimit fillestar, ajo humbet vlefshmërinë nga momenti i anulimit/ të saj dhe statusi nuk rikthehet në asnjë rrethanë.

5. Autoriteti përcakton rregullat për pezullimin e përkohshëm të certifikatave të kualifikuara për vulat elektronike sipas kushteve te meposhtme:

- a) nëse një certifikatë e kualifikuar për vulë elektronike është pezulluar përkohësisht, ajo certifikatë humbet vlefshmërinë e saj për periudhën e pezullimit;
- b) periudha e pezullimit do te tregohet qartë në bazën e të dhënave të certifikatës dhe statusi i pezullimit do të jetë i dukshëm, gjatë periudhës së pezullimit, nga shërbimi që ofron informacion mbi statusin e certifikatës.

6. Autoriteti nxjerr aktin nënligjor lidhur me listen e referencave të standardeve dhe specifikimet, procedurat për certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike Brenda 24 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian. Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në aneksin III të këtij ligji do të merren ne konsiderate kur një certifikatë e kualifikuar për vulën elektronike përputhet me ato standarde, specifikime dhe procedura.

## **Neni 48**

### **Pajisjet për krijimin e vulave elektronike të kualifikuara**

[Type here]

1. Kërkesat për pajisjet e krijimit të vulave elektronike të kualifikuara, janë të njëjtat me ato të përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji.
2. Kërkesat për certifikimin e pajisjeve të krijimit të vulave elektronike të kualifikuara, janë të njëjtat me ato të përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji.
3. Kërkesat për publikimin e një liste të pajisjeve të certifikuara për krijimin e vulës elektronike të kualifikuar, janë të njëjtat me ato të përcaktuara në nenin 39 të këtij ligji.

#### **Neni 49**

##### **Kërkesat për shërbimin e kualifikuar për menaxhimin e pajisjeve të krijimit të vulave elektronike të kualifikuara në distancë**

Përcaktimet në nenin 37 të këtij ligji zbatohen edhe për shërbimin e kualifikuar për menaxhimin e pajisjeve të krijimit të vulave elektronike të kualifikuara në distancë.

#### **Neni 50**

##### **Shërbimi i vërtetimit të vlefshmërisë dhe ruajtjes së vulave elektronike të kualifikuara**

Përcaktimet e bëra në nenet 40, 42 dhe 43 të këtij ligji, zbatohen edhe për vërtetimin e vlefshmërisë dhe ruajtjes së vulave elektronike të kualifikuara.

#### **Neni 51**

##### **Kërkesat për vërtetimin e vlefshmërisë së vulave elektronike të avancuara bazuar në certifikata të kualifikuara**

Përcaktimet në nenin 41 të këtij ligji zbatohet edhe për vërtetimin e vlefshmërisë së vulave elektronike të avancuara bazuar në certifikata të kualifikuara.

### **SEKSIONI 6**

#### **VULAT ELEKTRONIKE KOHORE TË KUALIFIKUARA**

#### **Neni 52**

##### **Efektet ligjore të vulës elektronike kohore të kualifikuar**

1. Vula elektronike kohore e kualifikuar konsiderohet e pranueshme në procedurat ligjore, pavarësisht se është në formë elektronike.
2. Vula elektronike kohore e kualifikuar, garanton saktësinë e datës dhe orës që tregon dhe integritetin e të dhënave me të cilat lidhet data dhe ora.

[Type here]

## Neni 53

### **Kërkesat për vulën elektronike kohore të kualifikuar**

1. Vula elektronike kohore e kualifikuar plotëson kërkesat e mëposhtme:

- a) lidh datën dhe orën me të dhënat, në mënyrë të tillë që çdo ndryshim i mundshëm i këtyre të dhënave të jetë i identifikueshëm;
- b) bazohet në një burim të saktë kohor, të lidhur me Orën Universale të Koordinuar (UTC); dhe
- c) nënshkruhet duke përdorur një nënshkrim elektronik të avancuar ose vulosje me një vulë elektronike të avancuar të ofruar nga një ofruar i kualifikuar të shërbimit të besuar, ose me ndonjë metodë ekuivalente

2. Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, merren në konsideratë kur lidhja e datës dhe orës me të dhënat dhe saktësia e burimit të kohës përputhen me standardet, specifikimet dhe procedurat e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

3. Autoritetit nxjerrë akte nënligjore, lidhur me listën e referencave të standardeve, përcaktimin e specifikimeve dhe procedurave për lidhjen e datës dhe orës me të dhënat dhe për përcaktimin e saktësisë së burimeve kohore brenda 24 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian.

## **SEKSIONI 7**

### **SHËRBIMET ELEKTRONIKE TË REGJISTRUARA**

## Neni 54

### **Efektet ligjore të ofrimit të shërbimeve elektronike të regjistruara**

1. Të dhënat e dërguara dhe të marra duke përdorur një shërbim elektronik të regjistruar, nuk duhet t'i mohohet efekti ligjor dhe pranueshmëria si provë në procedurat ligjore vetëm me arsyetimin se është në formë elektronike apo se nuk i plotëson kërkesat e ofrimit të shërbimit elektronik të kualifikuar të regjistruar.

2. Të dhënat e dërguara dhe të marra për ofrimin e shërbimit elektronik të kualifikuar të regjistruar, garantojnë integritetin e të dhënave, dërgimin e të dhënave nga dërguesi i identifikuar, pranimin e tyre nga marrësi i identifikuar, si dhe saktësinë e datës dhe orës së dërgimit dhe të marrjes, të vërtetueshme nga shërbimi elektronik i kualifikuar i regjistruar.

## Neni 55

### **Kërkesat për ofrimin e shërbimeve elektronike të kualifikuara të regjistruara të transmetimit**

1. Ofrimi i shërbimit elektronik të kualifikuar të regjistruar të transmetimit plotëson kërkesat si më poshtë:

[Type here]

- a) ofrohet nga një ose më shumë Ofrues të Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara;
- b) garanton nivel të lartë sigurie për identifikimin e dërguesit;
- c) siguron identifikimin e marrësit para transmetimit të të dhënave;
- ç) dërgimi dhe pranimi i të dhënave garantohen nga një nënshkrim elektronik i avancuar ose nga një vulë elektronike e avancuar e një Ofruesi të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, në mënyrë të tillë që cdo ndryshim i mundshëm i ketyre të dhënave të jete i identifikueshem;
- d) çdo ndryshim i të dhënave, i nevojshëm për qëllimin e dërgimit apo pranimit të të dhënave, i tregohet në mënyrë të qartë dërguesit dhe marrësit të të dhënave;
- dh) data dhe ora e dërgimit dhe pranimit të të dhënave, si dhe çdo ndryshim i tyre tregohen nga një vulë elektronike kohore e kualifikuar.

2. Në rast se të dhënat transferohen midis dy ose më shumë ofrueseve të kualifikuar të shërbimit elektronik të kualifikuar të regjistruar, kërkesat e përcaktuara në shkronjat a dhe dh , të këtij neni zbatohen edhe nga ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar të cilit i janë transferuar të dhënat.

3. Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni do të merren në konsideratë kur procesi për dërgimin dhe marrjen e të dhënave është në përputhje me standardet, specifikimet dhe procedurat e përmendura në pikën 2 të këtij neni .

4. Autoriteti përcakton me akt nënligjor një listë reference të standardeve specifikimet dhe procedurat për proceset për dërgimin dhe marrjen e të dhënave Brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga KE.

5. Ofruesit e shërbimeve elektronike të kualifikuara të regjistruara të transmetimit mund të bien dakord për ndërveprimin midis shërbimeve të kualifikuara të dërgesave elektronike të regjistruara që ata ofrojnë. ndërveprimi duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe kjo përputhshmëri duhet të konfirmohet nga një organ i vlerësimit të konformitetit.

6 Autoriteti nxjerr akt nënligjor, lidhur me listën e referencave të standardeve dhe specifikimet , procedurat për kuadrin e ndërveprimit të përmendur në pikën 5 të këtij neni në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian. Specifikimet teknike dhe përmbajtja e standardeve duhet të jenë me kosto efektive dhe proporcionale.

## **SEKSIONI 8**

### **AUTENTIFIKIMI I FAQEVE TË INTERNETIT**

#### **Neni 56**

#### **Kërkesat për certifikata të kualifikuara për autentifikimin e faqeve të internetit**

1. Certifikatat e kualifikuara për autentifikimin e faqeve të internetit duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në aneksin IV të këtij ligji. Vlerësimi i përputhshmërisë me këto kërkesa kryhet në përputhje me standardet, specifikimet dhe procedurat e përmendura në pikën 2 të këtij neni.
2. Certifikatat e kualifikuara për autentifikimin e faqeve të internetit të lëshuara në përputhje me pikën 1 të këtij neni njihen nga ofruesit e shfletuesve të internetit (*web-browsers*). Ofruesit e shfletuesve të

[Type here]

internetit (*web-browsers*) sigurojnë që të dhënat e identitetit dhe atributet shtesë të treguara në certifikate janë lehtësisht të përdorshme për përdoruesit. Ofruesit e shfletuesve të internetit (ëb-browsers) sigurojnë mbështetje dhe ndërveprim me certifikata të kualifikuara për autentifikimin e faqeve të internetit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, sipas legjislacionit në fuqi për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla të, mesme.

3. Certifikatat e kualifikuara për autentifikimin e faqeve të internetit nuk do të kenë kërkesa shtesë të detyrueshme përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Autoriteti përcakton me akt nënligjor një listë reference të standardeve dhe përcakton specifikimet dhe procedurat për certifikatat e kualifikuara për autentifikimin e faqes së internetit, të përmendura në pikën 1 të këtij neni brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian.

## **Neni 57**

### **Masat parandaluese të sigurisë kibernetike**

1. Ofruesit e shfletuesve të internetit nuk do të marrin asnjë masë në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në nenin 56 të këtij ligji, veçanërisht kërkesat në lidhje me njohjen e certifikatave të kualifikuara për autentifikimin e faqes në internet dhe shfaqjen e të dhënave të identitetit të ofruara në mënyrë të tillë që të jenë lehtësisht të përdorshme për përdoruesit.

2. Me përjashtim të pikës 1 të këtij neni dhe vetëm në rast të shqetësimeve të ngritura në lidhje me shkeljet e sigurisë ose humbjes së integritetit të një certifikate ose grup certifikatash të identifikuar, ofruesit e shfletuesve të internetit mund të marrin masa parandaluese në lidhje me atë certifikatë ose grup certifikatash.

3. Kur një ofrues i një shfletuesit të internetit merr masa paraprake në përputhje me pikën 2 të këtij neni, ky i fundit njofton menjehere, autoritetin, subjektin të cilit i është lëshuar certifikata si dhe ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar që ka lëshuar atë certifikatë ose grup certifikatash, problematikat me shkrim, së bashku me një përshkrim të masave të marra për të zbutur këto problematika. Pas marrjes së një njoftimi të tillë, autoriteti lëshon një vërtetim për njohjen e problematikës, ofruesit të shfletuesit të internetit.

4. Autoriteti verifikon çështjet e ngritura mbi njoftimin e marre në përputhje me përcaktimet e shkronjës “k” pika 4 të nenit 71 të këtij ligji. Nëse në përfundim të verifikimit, nga ana e Autoritetit konstatohet se nuk ka shkaqe për tërheqjen e statusit të kualifikuar të certifikatës, Autoriteti informon ofruesin e shfletuesit të internetit në përputhje me rrethanat dhe i kërkon ofruesit t'i japë fund masave parandaluese të përmendura në pikën 2 të këtij neni.

## **KREU III**

### **SEKSIONI 9**

#### **VËRTETIM ELEKTRONIK I ATRIBUTEVE**

[Type here]



## **Neni 58**

### **Efektet ligjore të vërtetimit elektronik të atributiveve**

1. Vërtetimit elektronik të atributiveve do t'i njihet efekti ligjor ose pranueshmëria si provë në procedurat ligjore pavarësisht se është në formë elektronike apo se nuk plotëson kërkesat për vërtetime elektronike të kualifikuara të atributiveve.
2. Vërtetimi elektronik të kualifikuar të atributiveve dhe vërtetimit të atributiveve të lëshuar nga, ose në emër të një institucioni të sektorit publik përgjegjës për një burim autentik do të ketë të njëjtin efekt ligjor si vërtetimet e lëshuara ligjërisht në formë letre.

## **Neni 59**

### **Vërtetim elektronik i atributiveve në shërbimet publike**

Për shërbimet online të ofruara nga një organ i sektorit publik, për të cilët kërkohet identifikimi elektronik nëpërmjet një mjeti të identifikimit dhe autentifikimit elektronik, të dhënat e identifikimit të personit në vërtetimin elektronik të atributiveve nuk do të zëvendësojnë identifikimin elektronik duke përdorur një mjet identifikimi elektronik dhe autentifikim për identifikimin elektronik përveç rasteve kur lejohet në mënyrë specifike nga legjislativi kombëtar. Ky përcaktim vlen edhe për rastet e vërtetimit elektronik të kualifikuar të atributiveve.

## **Neni 60**

### **Kërkesat për vërtetimin elektronik të kualifikuar të atributiveve**

1. Vërtetimi elektronik i kualifikuar i atributiveve plotëson kërkesat e përcaktuara në aneksin V të këtij ligji .
2. Vlerësimi i përputhshmërisë me kërkesat e përcaktuara në aneksin V të këtij ligji kryhet në përputhje me standardet, specifikimet dhe procedurat e përmendura në pikën 5 të këtij neni.
3. Vërtetimet elektronike të kualifikuara të atributiveve nuk do të kenë kërkesa të tjera të detyrueshme përveç kërkesave të përcaktuara në aneksin V të këtij ligji.
4. Kur një vërtetim elektronik i kualifikuar i atributiveve është anuluar/ pas lëshimit fillestar, ai e humbet vlefshmërinë e tij që nga momenti i anulimit dhe statusi i tij nuk do të rikthehet në asnjë rrethanë.
5. Autoriteti brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji përcakton një listë reference të standardeve dhe përcakton specifikimet dhe procedurat për vërtetimin elektronik të kualifikuar të atributiveve në përputhje me aktet e nxjerra nga KE. Këto akte nenligjore do të jenë në përputhje me aktet referuar në nenin 5a pika 23 mbi zbatimin e Portofolit Evropian të Identitetit Digjital.

## **Neni 61**

### **Verifikimi i atributiveve kundrejt burimeve autentike**

[Type here]

1. Autoriteti siguron, që brenda 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të përmendura në nenet 6 dhe 8 pika 6, për atributet e renditura në aneksin VI të këtij ligji, kudo që këtotribute mbështeten në burime autentike brenda sektorit publik, janë marrë masa për të lejuar ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara të vërtetimeve elektronike të attributeve që t'i verifikojnë atotribute me mjete elektronike me kërkesë të përdoruesit, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

2. Autoriteti, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare përkatëse, do të nxjerrë akte nënligjore, që të krijojë një listë referencë të standardeve dhe do të përcaktojë specifikimet dhe procedurat për katalogun e attributeve, si dhe skemat për vërtetimin e attributeve dhe procedurave të verifikimit për vërtetimet elektronike të kualifikuara të attributeve në zbatim të pikës 1 të këtij neni në përputhje me aktet e nxjerra nga BE. Këto akte nënligjore do të jenë në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian mbi zbatimin e Portofolit të Identitetit Digjital.

## Neni 62

### **Kërkesat për vërtetimin elektronik të attributeve të lëshuara nga ose në emër të një organi të sektorit publik përgjegjës për një burim autentik**

1. Një vërtetim elektronik i attributeve të lëshuar nga ose në emër të një organi të sektorit publik përgjegjës për një burim autentik plotëson kërkesat e mëposhtme:

a) Përmbush kërkesat e përcaktuara në aneksin VII të këtij ligji;

b) Certifikatën e kualifikuar që mbështet nënshkrimin elektronik të kualifikuar ose vulën elektronike të kualifikuar të organit të sektorit publik të përmendur në nenin 3 pika 47 të këtij ligji, i identifikuar si lëshuesi i përmendur në pikën (b), të aneksit VII të këtij ligji, që përmban një grup specifik të certifikuar të attributeve në një formë të përshtatshme për përpunim të automatizuar:

i. duke treguar se organi lëshues është krijuar në përputhje me përcaktimet e legjislacionit kombëtar si përgjegjës për burimin autentik mbi bazën e të cilit është lëshuar vërtetimi elektronik i attributeve ose si organi i caktuar për të vepruar në emër të tij;

ii. sigurimin e një grupi të dhënash që përfaqësojnë në mënyrë të qartë burimin autentik të përmendur në shkronjën (i) të kësaj pike; dhe

iii. në zbatim të ligjit kombëtar të përmendur në shkronjën (i) të kësaj pike.

2. RSH siguron që organet e sektorit publik të përmendura në nenin 3, pika 47, të cilët lëshojnë vërtetime elektronike të attributeve të përmbushin një nivel sigurie të barabartë me ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara në përputhje me nenin 24 të këtij ligji.

3. Autoriteti publikon listën e organeve të sektorit publik të përmendura në nenin 3, pika 47 të këtij neni. Kjo liste përfshin raportin e vlerësimit të konformitetit të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit që konfirmon se kërkesat e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 6 të këtij neni janë përmbushur.

4. Kur një vërtetim elektronik i attributeve i lëshuar nga ose në emër të një organi të sektorit publik përgjegjës për një burim autentik është anuluar pas lëshimit fillestar, ai do të humbasë vlefshmërinë e tij nga momenti i anulimit të tij dhe statusi i tij nuk do të rikthehet.

[Type here]

5. Një vërtetim elektronik i atributiveve të lëshuar nga ose në emër të një organi të sektorit publik përgjegjës për një burim autentik konsiderohet se është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kur është në përputhje me standardet, specifikimet dhe procedurat e përmendura në pikën 6 të këtij neni.

6. Autoriteti përcakton me akt nënligjor një listë reference të standardeve dhe specifikimeve, procedurave për vërtetimin elektronik të atributiveve të lëshuara nga ose në emër të një organi të sektorit publik përgjegjës për një burim autentik brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga KE. Këto akte nënligjore do të jenë në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian mbi zbatimin e Portofolit të Identitetit Digjital.

7. Autoriteti përcakton me akt nënligjor, një listë reference të standardeve, specifikimet dhe procedurat për qëllimet e pikës 3 të këtij neni brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian. Këto akte nënligjore do të jenë në përputhje me aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian mbi zbatimin e Portofolit të Identitetit Digjital.

8. Organet e sektorit publik të përmendura në nenin 3, pika 47 e këtij ligji, që lëshojnë vërtetimin elektronik të atributiveve sigurojnë një ndërfaqe me portofolët e identitetit digjital që ofrohen në zbatim të nenit 6 të këtij ligji .

### **Neni 63**

#### **Lëshimi i vërtetimit elektronik të atributiveve të Portofolave të identitetit digjital**

1. Ofruesit e vërtetimeve elektronike të atributiveve i ofrojnë përdoruesve të Portofolit të Identitetit Digjital mundësinë për të kërkuar, marrë, ruajtur dhe menaxhuar vërtetimin elektronik të atributiveve,
2. Ofruesit e vërtetimeve elektronike të kualifikuara të atributiveve do të ofrojnë një ndërfaqe me portofolët e identitetit digjital që ofrohen në zbatim të nenit 6 të këtij ligji.

### **Neni 64**

#### **Rregulla shtesë për ofrimin e shërbimeve të vërtetimit elektronik të atributiveve**

1. Ofruesit e shërbimeve të vërtetimit elektronik të kualifikuar dhe jo të kualifikuar të atributiveve nuk do të ndërthurin të dhënat personale në lidhje me ofrimin e këtyre shërbimeve me të dhënat personale nga çdo shërbim tjetër i ofruar nga ata ose ofrues të tjerë.
2. Të dhënat personale në lidhje me ofrimin e shërbimeve të vërtetimit elektronik të atributiveve mbahen logjikisht të ndara nga të dhënat e tjera të mbajtura nga ofruesi i vërtetimit elektronik të atributiveve.
3. Ofruesit e shërbimeve të vërtetimit elektronik të kualifikuar të atributiveve zbatojnë ofrimin e këtyre shërbimeve të kualifikuara të besuara në një mënyrë që funksionalisht të jetë e ndarë nga shërbimet e tjera të ofruara prej tyre.

[Type here]

## SEKSIONI 10

### SHËRBIMET E ARKIVIMIT ELEKTRONIK

#### Neni 65

##### Efekti ligjor i shërbimeve të arkivimit elektronik

1. Të dhënat elektronike dhe dokumentet elektronike të ruajtura duke përdorur një shërbim arkivimi elektronik nuk do t'u mohohet efekti ligjor ose pranueshmëria si provë në procedurat ligjore vetëm me arsyetimin se ato janë në formë elektronike ose se nuk ruhen duke përdorur një shërbim të kualifikuar të arkivimit elektronik.
2. Për të dhënat elektronike dhe dokumentet elektronike të ruajtura duke përdorur një shërbim të kualifikuar të arkivimit elektronik merret në konsideratë integriteti dhe origjina e tyre për kohëzgjatjen e periudhës së ruajtjes nga ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar.

#### Neni 66

##### Kërkesat për shërbime të kualifikuara të arkivimit elektronik

1. Shërbimet e kualifikuara të arkivimit elektronik plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
  - a) Ofrohen nga ofrues të kualifikuar të shërbimeve të besuara;
  - b) përdorin procedura dhe teknologji të pershtatshme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe lexueshmërinë e të dhënave elektronike dhe dokumenteve elektronike përtej periudhës së vlefshmërisë teknologjike dhe të paktën gjatë gjithë periudhës së ruajtjes ligjore ose kontraktuale, duke ruajtur integritetin dhe saktësinë e origjinës së tyre;
  - c) Sigurojnë që ato të dhëna elektronike dhe ato dokumente elektronike të ruhen në mënyrë të tillë që të mbrohen nga humbja dhe ndryshimi, me përjashtim të ndryshimeve në lidhje me mediumin ose formatin e tyre elektronik;
  - d) T'i lejojnë palët mbeshtetese të autorizuar të marrin një raport automatik që konfirmon se të dhënat elektronike dhe dokumentet elektronike të marra nga një arkiv elektronik i kualifikuar duke marrë në konsideratë integritetin e të dhënave nga fillimi i periudhës së ruajtjes deri në momentin e marrjes.Raporti i përmendur në shkronjën d, të pikes 1 të këtij neni duhet të sigurohet në mënyrë të besueshme dhe efikase dhe të ketë nënshkrimin elektronik të kualifikuar ose vulën elektronike të kualifikuar të ofruesit të shërbimit të kualifikuar të arkivimit elektronik.
2. Autoritetu përcakton me akt nënligjor, një listë reference të standardeve specifikuara dhe procedurat për shërbimet e kualifikuara të arkivimit elektronik brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga KE Pajtuueshmëria me kërkesat për shërbime të kualifikuara të arkivimit elektronik do të konsiderohet kur një shërbim i kualifikuar i arkivimit elektronik përputhet me standardet, specifikuara dhe procedurat.

[Type here]

**SEKSIONI 11**  
**REGJISTRAT ELEKTRONIKE**

**Neni 67**

**Efektet ligjore të regjistrit elektronik**

1. Regjisterit elektronik do i njihet efekti ligjor ose pranueshmëria si provë në procedurat ligjore pavaresisht se është në formë elektronike apo se nuk plotëson kërkesat për regjistrat të kualifikuar elektronik.
2. Të dhënat e regjistruara të përfshira në një regjister të kualifikuar elektronik do të konsiderohen, renditja e njëpasnjëshme kronologjike dhe integriteti i tyre si unike dhe të sakta.

**Neni 68**

**Kërkesat për regjistra elektronikë të kualifikuar**

1. Regjistrat elektronikë të kualifikuar plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
  - a) krijohen dhe menaxhohen nga një ose më shumë ofrues të kualifikuar të shërbimeve të besuara;
  - b) përcaktimin e origjines se të dhënave të regjistruara në regjistrin kryesor;
  - c) renditjen e të dhënave të regjistruara në regjister në mënyrë kronologjike, unike dhe sekuenciale;
  - d) regjistrimin e të dhënave në mënyrë të tillë që çdo ndryshim i mëvonshëm i të dhënave të identifikohet menjëherë, duke siguruar integritetin e tyre me kalimin e kohës.
2. Pajtueshmëria me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, merret në konsideratë kur një regjister elektronik përputhet me standardet, specifikimet dhe procedurat e përmendura në pikën 3 të këtij neni.
3. Autoriteti përcakton me akt nënligjore, një listë reference të standardeve, specifikimet dhe procedurat për kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji në përputhje me aktet e nxjerra nga KE.

**KREU IV**

**DOKUMENTA ELEKTRONIKE**

**Neni 69**

**Efektet ligjore të dokumenteve elektronike**

[Type here]

Dokumentit elektronik nuk i mohohet efekti ligjor dhe pranueshmëria si provë në procedurat ligjore vetëm për arsye se është në formë elektronike.

## KREU V

### QEVERISJA

#### Neni 70

#### **Mbikëqyrja e kuadrit ligjor të Portofolit të Identitetit Digjital**

1. Autoriteti është organi mbikëqyrës për mbikëqyrjen e Portofolit të Identitetit Digjital në Republikën e Shqipërisë, i cili ka kompetencat e nevojshme dhe burimet e duhura për ushtrimin e detyrave të tyre në mënyrë efektive.
2. Autoriti sipas pikes 1 të këtij neni kryen detyrat si më poshtë :
  - a) mbikëqyr ofruesit e portofoleve të identitetit digjital dhe siguron, që ata përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;
  - b) ndërmerr veprime, nëse është e nevojshme, në lidhje me ofruesit e portofoleve të identitetit Digjital kur informohen se ofruesit ose Portofolet e Identitetit Digjital që ata ofrojnë në kundërshtim me përcaktimet e bera në këtë ligj.
  - c) bashkëpunon me organet e tjera mbikëqyrëse dhe u ofron atyre ndihmë sipas përcaktimeve në nenet 72 dhe 74 të këtij ligji;
  - d) kërkon informacionin e nevojshëm për të monitoruar përmbushjen e kërkesave ligjore sipas përcaktimeve në këtë ligji;
  - e) informon për çdo shkelje të rëndësishme të sigurisë ose humbje të integritetit për të cilën Autoriteti merr dijeni gjatë kryerjes së detyrave të tij dhe , në rastin e një shkeljeje të konsiderueshme të sigurisë ose humbjes së integritetit që ka të bëjë me transaksionet ndërkufitare informon autoritetin përgjegjës të shtetit të prekur me qëllim informimin e publikut ose për të kërkuar nga ofruesi i portofolit të identitetit digjital të njoftojnë shkeljen e sigurisë apo humbjen e integritetit e cila është në interes të publikut;
  - f) kryen inspektime në vend dhe në distancë;
  - g) kërkon nga ofruesit e portofoleve të identitetit digjital të korrigjojnë çdo mangësi lidhur me përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në këtë ligj;
  - gj) pezullon ose anulon regjistrimin dhe përfshirjen e palëve përfshira në mekanizmin e përmendur në nenin 7, pika 7 në rastin e përdorimit të paligjshëm të Portofolit të Identitetit Digjital;
  - h) bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në mënyrë të veçantë duke i informuar menjëherë kur vihet re se janë shkelur rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale dhe për shkeljet e sigurisë që vihen re se përbëjnë shkelje në të dhëna personale;

[Type here]

3. Kur Autoriteti kërkon që ofruesi i një portofoli të identitetit digjital të korrigojë çdo mangesi në përmbushjen e kërkesavesipas pikes 4, shkronja “e” te ketij neni , dhe kur ofruesi nuk vepron në përputhje me rrethanat dhe, brenda një afati kohor të caktuar nga Autoriteti, atehere ky I fundit duke marrë ne konsiderate , shtrirjen, kohëzgjatjen dhe pasojat e ketyre mangesive urdhëron ofruesin të pezullojë ose të ndërpresë ofrimin e Portofolit te identitetit digjital. Autoriteti informon menjëherë për vendimin për të kërkuar pezullimin ose ndërprerjen e ofrimit të Portofolit të identitetit Digjital përdoruesit e Portofolit të Identitetit Digjital, palët e përfshira si dhe shtetet e tjera në rastin e transaksioneve ndërkuftare.

4. Deri më 31 mars të çdo viti, Autoriteti harton një raport mbi aktivitetet kryesore për vitin e kaluar kalendarik dhe e publikon atë në faqen zyrtare të tij

## Neni 71

### Mbikëqyrja e shërbimeve të besuara

1. AKSK është autoriteti përgjegjes mbikëqyrës per shërbimet e besuara
2. Me anëtaresimin në BE, RSH do t'ij bëj të ditur Komisionit Evropian emrin dhe adresen e autoritetit përgjegjëse për mbikëqyrjen e shërbimeve të besuara.
3. Kompetencat e autoritetit për mbikëqyrjen e shërbimeve të besuara janë:
  - a) mbikëqyrë ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara të vendosur në territorin e RSH dhe siguron, dhënie e statusit i kualifikuar “për OKSHB-të si dhe mbikëqyr veprimtarinë e OKSHB lidhur me përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në këtë ligj;
  - b) ndërmer veprime mbikëqyrëse, nëse është e nevojshme, në lidhje me ofruesit e pakualifikuar të shërbimeve të besuara të vendosur në territorin e RSH, kur ka informacion se këta ofrues të pakualifikuar të shërbimit të besuar ose shërbimet e besuara të ofruara prej tyre, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;
  - c) mbikëqyr ofruesit e shërbimeve të besuara lidhur me përmbushjen e kërkesave të sigurisë kibernetike sipas përcaktimeve në fuqi të legjislacionit për sigurinë kibernetike si dhe informacion publikun në rast të shkeljes së sigurisë apo humbjes së integritetit të Portofolit të Identitetit Digjital;
  - d) bashkëpunojë me autoritet mbikëqyrëse të shërbimeve të besuara të shteteve të tjera brenda fushës së përgjegjësisë së tij;
  - e) analizon raportet e vlerësimit të konformitetit të përmendura në nenin 27 pika 1 të këtij ligji dhe nenin 28 pika 1 të këtij ligji;
  - f) Me anëtarësimin e RSH në BE Autoriteti raporton pranë Komisionit për aktivitetet kryesore në përëuthje me pikën 6 të këtij neni;  
kryen kontrole ose kërkon nga një organ i vlerësimit të konformitetit të kryejë një vlerësim të konformitetit të ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara sipas përcaktimeve të nenit 27 pika 2 të këtij ligji;

[Type here]

- g) bashkëpunon me autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale duke i informuar menjëherë në rast se dyshohen shkelje të rregullave të mbrojtjes së të dhënave personale dhe për shkelje të e sigurisë që vihen re se përbëjnë shkelje në të dhëna personale;
  - gj) jap statusin i kualifikuar ofruesve të shërbimeve të besuara dhe shërbimeve që ata ofrojnë, dhe tërheqë statusin i kualifikuar sipas përcaktimeve të neneve 27 dhe 28 të këtij ligji;
  - h) publikon listen e besuar kombëtare sipas përcaktimeve të nenit 29 pika 3 të këtij ligji, si dhe vendimet e tij për dhënien ose heqjen e statusit i kualifikuar;
  - i) verifikon ekzistencën dhe zbatimin e saktë të dispozitave për planin e përfundimit kur ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar ndërpret aktivitetin e tij, duke përfshirë mënyrën se si informacioni mbahet i aksesueshëm në përputhje me nenin 31 pika 4, shkronja j;
  - j) kërkon nga ofruesit e shërbimeve të besuar të korrigjojnë çdo mangësi për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në këtë ligj;
  - k). shqyrton pretendimet e bëra nga ofruesit e shfletuesve të internetit / web-browsers sipas përcaktimeve të nenit 57 dhe nëse është e nevojshme merrmasa.
3. Autoriteti sipas përcaktimeve me pikën 1 të këtij neni krijon, mirëmban dhe përditëson një infrastrukturë të besuar.
4. Deri më 31 mars të çdo viti autoriti harton një raport në lidhje me aktivitetet kryesore të shërbimeve të besuara, të cilin e paraqet në Këshillin e Ministrave si dhe me anëtarësimin në BE ia paraqet këtë raport Komisionit Evropian.

## **Neni 72**

### **Pikat e vetme të kontaktit**

1. Autoriteti është pikë të vetme kontaktit për shërbimet e besuara, portofolët e identitetit digjital dhe skemat e identifikimit elektronik .
2. Autoriteti koordinon dhe bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të shteteve të tjera për ofruesit e shërbimeve të besuara për ofruesit e portofolëve të identitetit digjital dhe sipas rastit, me Komisionin dhe Agjencinë e Bashkimit Evropian për Sigurinë Kibernetike (ENISA)
3. Autoriteti publikon menjëherë emrin dhe adresën e pikës së vetme të kontaktit të caktuar sipas përcaktimeve në pikën 1 të këtij neni si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm.

## **Neni 73**

### **Ndihma e ndërsjellë**

1. Për të lehtësuar mbikëqyrjen dhe zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj si dhe me synimin për të shkëmbyer praktikat më të mira Autoriteti bashkëpunon me autoritetet mbikëqyrëse të shërbimeve të besuara të shteteve të tjera.
2. Autoriteti bashkëpunon me organet mbikëqyrëse të vendeve të tjera, kryesisht lidhur me:
  - a) kërkesat për informacion;
  - b) masat mbikëqyrëse;

[Type here]



c) kërkesat për të kryer inspektime në lidhje me raportet e vlerësimit të konformitetit referuar në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji

d) për të kryer kontrole të përbashkëta me stafet e organeve mbikëqyrëse të Shteteve të tjera

3. Autoriteti nënshkruan marrëveshje me autoritetet mbikëqyrëse të shteteve të tjera, në të cilën detajohen procedurat me qëllim arritjen e ndihmes të ndërsjelle sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për marrëveshjet nderkombetare

4. Në rastet e paraqitjes së një kërkesë për ndihmë, Autoriteti mund ta refuzojë këtë kërkesë në rastet kur :

a) ndihma e kërkuar nuk është në proporcion me kompetencat mbikëqyrëse të Autoritetit mbikëqyrës sipas përcaktimeve në nenet 70 dhe 71;

b) nuk është kompetent për të ofruar ndihmën e kërkuar;

c) ofrimi i ndihmës së kërkuar nuk është në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

## **Neni 74**

### **Grupi Evropian i Bashkëpunimit të Identitetit Digjital**

Me anëtarësimin në Bashkimin Evropian, Autoriteti merr pjesë në aktivitetet e grupit Evropian të bashkëpunimit të identitetit, të përbërë nga përfaqësues të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të Komisionit Evropian duke kontribuar kryesisht, për:

a) Shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira në fushën e portofoleve të identitetit digjital, mjeteve të identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara

b) shkëmbejnë informacionin, pikëpamjet, dhe praktikat më të mira mbi aspektet përkatëse të sigurisë kibernetike në lidhje me portofolet e identitetit digjital, skemat e identifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara;

c) shkëmbejnë praktikat më të mira në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e politikave për njoftimin e shkeljeve të sigurisë dhe masave të përbashkëta

d) shkëmbyer informacione përkatëse në lidhje me shërbimet e besuara dhe identifikimin elektronik lidhur me kërcënimet kibernetike, incidentet, dobësitë, iniciativat për rritjen e ndërgjegjësimit, trajnimet, ushtrimet dhe aftësitë, ngritja e kapaciteteve, standardet dhe specifikimet teknike

## **Neni 75**

### **Dispozita kalimtare**

1. Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr.107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar dhe ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, nëse nuk janë në kundërshtim me këtë ligj, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve nënligjore sipas nenit 76, të këtij ligji.

[Type here]

2. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara që lëshojnë certifikata të kualifikuara për nënshkrimin elektronik, të regjistruar në bazë të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, vazhdojnë të funksionojnë si Ofrues të Shërbimit të Kualifikuar që lëshojnë certifikata të kualifikuara për nënshkrimin elektronik.

3. Ofruesit e Shërbimeve të Besuara referuar në pikën 2, të këtij neni, janë të detyruar të harmonizojnë veprimtarinë e tyre me dispozitat e këtij ligji brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe të paraqesin pranë Autoritetit një raport të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit.

#### **Neni 76**

#### **Nxjerrja e akteve nëligjore**

#### **Neni 77**

#### **Shfuqizime**

Ligji nr.107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar dhe ligji nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

#### **Neni 78**

#### **Hyrja në fuqi**

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
2. Nenet 6, pika 18, 8, pika 3 dhe 7, 9, pika 1, 71, pikat 2, 3 shkronja “f” dhe pika 4, 74 hyjnë në fuqi me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

## **ANEKSI I**

### **KERKESAT PER CERTIFIKATA TE KUALIFIKUARA PER NENSHKRIME ELEKTRONIKE**

Certifikatat e kualifikuara për nënshkrime elektronike duhet të përmbajnë:

- a) një tregues, të paktën në një format të përshtatshëm për përpunim të automatizuar, që certifikata është lëshuar si certifikatë e kualifikuar për nënshkrim elektronik;
- b) një grup të dhënash që përfaqësojnë në mënyrë të qartë ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar që lëshon certifikatat e kualifikuara, duke përfshirë të paktën shtetin në të cilin ky ofrues është vendosur dhe:

-për një person juridik: emrin dhe, numrin (NUIS) e regjistrimit që figuron në të dhënat zyrtare,

-për një person fizik: emri i personit;

c) të paktën emrin e nënshkruesit, ose një pseudonim; nëse përdoret një pseudonim, duhet të tregohet në mënyrë të qartë;

d) të dhënat e vlefshmerisë të nënshkrimit elektronik të cilat korrespondojnë me të dhënat e krijimit të nënshkrimit elektronik;

e) detajet e fillimit dhe përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së certifikatës;

f) kodin identifikues të certifikatës, i cili duhet të jetë unik për ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar;

g) nënshkrimin elektronik të avancuar ose vulën elektronike të avancuar të lëshuar nga ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar;

h) vendndodhjen e certifikatës perkatese të nënshkrimit elektronik të avancuar ose vulës elektronike të avancuar të përmendur në shkronjen (g) të kësaj pike e cila ofrohet pa pagesë;

[Type here]

i) informacionin ose vendndodhjen e shërbimeve që mund të përdoren për të njohur statusin e vlefshmërisë së certifikatës së kualifikuar;

j) sipas rastit, një tregues të përshtatshëm që mundëson përpunimin automatik, që tregon se të dhënat për krijimin e një nënshkrimi elektronik lidhen me të dhënat e vlefshmërisë së tij dhe janë vendosur në pajisjen për krijimin e një nënshkrimi elektronik të kualifikuar.

## **ANEKSI II**

### **Kërkesat për pajisjet e krijimit të nënshkrimit elektronik të kualifikuar**

1. Pajisjet për krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar, me anë të mjeteve të përshtatshme teknike dhe procedurale, duhet të sigurojnë të paktën që:
  - a) konfidencialiteti i të dhënave të krijimit të nënshkrimit elektronik të përdorura për këto nënshkrim elektronik të jete i sigurt
  - b) të dhënat e përdorura për krijimin e nënshkrimit elektronik mund të përdoren vetëm një herë
  - c) të dhënat për krijimin e një nënshkrimi elektronik me një shkallë të lartë sigurie, nuk mund të nxirren jashtë pajisjes për krijimin e nënshkrimit elektronik, si dhe mbrohen në mënyrë të besueshme kundër falsifikimit duke përdorur teknologjinë në dispozicion ;
  - d) të dhënat për krijimin e një nënshkrimi elektronik mund të mbrohen në mënyrë të sigurt nga nënshkruesi legjitim ndaj përdorimit të paautorizuar .
2. Pajisjet për krijimin e një nënshkrimi elektronik të kualifikuar, kur krijojnë një nënshkrim elektronik nuk mund t'i ndryshojnë të dhënat e nënshkruesit, apo të ndalojnë krijuesin e nënshkrimit të aksesojë të dhënat përpara procesit të krijimit të nënshkrimit elektronik të kualifikuar.

## **ANEKSI III**

### **Kërkesa për certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike**

Certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike përmbajnë:

- a) një tregues, që të ketë një formë të përshtatshme për përpunim të automatizuar, i cili tregon që certifikata është lëshuar si certifikatë e kualifikuar për vulën elektronike;

[Type here]

b) një grup të dhënash që përfaqësojnë qartesisht ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar që lëshon certifikatat e kualifikuara, duke përfshirë të paktën shtetin në të cilin është vendosur ai ofrues dhe:

-për një person juridik: emrin dhe numrin e regjistrimit sipas të dhënave zyrtare,

- për një person fizik: emri i personit;

c) të paktën emrin e krijuesit të vulës dhe, sipas rastit, numrin e regjistrimit sipas të dhënave zyrtare;

d) vlefshmerine e të dhënave të vulës elektronike, që korrespondojnë me të dhënat e krijimit të vulës elektronike;

e) data e fillimit dhe përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së certifikatës;

f) kodin e identitetit të certifikatës, i cili duhet të jetë unik për ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar;

(g) the advanced electronic signature or advanced electronic seal of the issuing qualified trust service provider;

g) nënshkrimin elektronik të avancuar ose vulën elektronike të avancuar të leshuar nga ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar.

h) vendin ku leshohet certifikata për nënshkrimin elektronik të avancuar ose vulën elektronike të avancuar të përmendur në shkronjen g,) të kësaj pike që mundësohet pa pagesë;

i) informacionin ose vendndodhjen e shërbimeve që mund të përdoren për të kontrolluar statusin e vlefshmërisë së certifikatës së kualifikuar;

j) sipas rastit, një tregues të përshtatshëm që mundëson përpunimin automatik, që tregon se të dhënat për krijimin e një vule elektronike lidhen me të dhënat e vlefshmërisë së vulës dhe janë vendosur në pajisjen për krijimin e një vule elektronike të kualifikuar

#### **ANEKSI IV**

#### **Kërkesa për certifikata të kualifikuara për autentifikim të faqeve të internetit**

Certifikatat e kualifikuara për autentifikimin e faqeve të internetit përmbajnë:

a) një tregues, në format të përshtatshëm për përpunimin e automatizuar, që certifikata është leshuar si certifikatë e kualifikuar për autentifikimin e faqes së internetit;

b) një grup të dhënash që përfaqësojnë ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar që lëshon certifikatat e kualifikuara, duke përfshirë të paktën shtetin në të cilin ky ofrues është vendosur dhe:

[Type here]

- për një person juridik: emrin dhe numrin NUIS e regjistrimit qe figuron ne te dhënat zyrtare
- për një person fizik: emri i personit;
- c) për personat fizikë: të paktën emrin e personit të cilit i është dhënë certifikata, ose një pseudonim; nëse përdoret një pseudonim, ai duhet të tregohet ne menyre te qartë;
- ca) për personat juridikë: një grup unik të dhënash që përfaqësojnë në mënyrë të qartë personin juridik të cilit i është lëshuar certifikata, me të paktën emrin e personit juridik të cilit i është lëshuar certifikata dhe, sipas rastit, numrin NUIS të regjistrimit qe figuron në të dhënat zyrtare;
- d) adresës, duke përfshirë qytetin dhe shtetin, të personit fizik ose juridik të cilit i është lëshuar certifikata dhe ku eshte e aplikueshme, si figuron në të dhënat zyrtare;
- e) emrin/emrat e domain-it / domain-eve të menaxhuar nga personi fizik ose juridik të cilit i është lëshuar certifikata;
- f) data e fillimit dhe përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së certifikatës;
- g) kodin e identifikimit të certifikatës, i cili duhet të jetë unik për ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar;
- h) nënshkrimin elektronik të avancuar ose vulën elektronike të avancuar të leshuar nga ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar;
- i) Vendndodhjen e certifikates perkatese per nënshkrimin elektronik të avancuar ose vulën elektronike të avancuar të përmendur në shkronjen h të kësaj pike e cila ofrohet pa pagesë;
- j) informacionin ose vendndodhjen e statusit te vlefshmërisë se shërbimeve të certifikatës për të njohur statusin e vlefshmërisë së saj .

## **ANEKSI V**

### **Kërkesat për vërtetim elektronik të kualifikuar të atributiveve**

Vërtetimi elektronik i kualifikuar i atributiveve përmban:

- a) një tregues, në format të përshtatshem për përpunim të automatizuar, qe tregon që vërtetimi është lëshuar si një vërtetim elektronik i kualifikuar i atributiveve;
- b) (një grup të dhënash që përfaqësojnë ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar që lëshon vërtetimin elektronik të kualifikuar të atributiveve, duke përfshirë, Shtetin në të cilin është vendosur ai ofrues dhe
  - për një person juridik: emrin dhe numrin e regjistrimit NUIS qe figuron ne dhënat zyrtare;
  - për një person fizik: emri i personit;
- c) një grup të dhënash që përfaqësojnë subjektin të cilit i referohen atributet e vërtetuaradhe nëse përdoret një pseudonim, ai duhet të tregohet qartë;

[Type here]

- d) atributin ose atributet e vërtetuara, duke përfshirë, aty ku është e aplikueshme, informacionin e nevojshëm për të identifikuar qëllimin e këtyretributeve;
- e) datën e fillimit dhe përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së vërtetimit;
- f) kodin e identifikimit të vërtetimit, i cili duhet të jetë unik për ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar dhe, aty ku është e aplikueshme, treguesin e skemës së vërtetimeve që bën pjesë vërtetimi itributeve;  
nënshkrimin elektronik të kualifikuar ose vulën elektronike të kualifikuar të ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar;  
vendndodhjen e e certifikates për nënshkrimin elektronik të kualifikuar ose vulën elektronike të kualifikuar të përmendur në shkronjen g, e cila ofrohet pa pagesë;
- g) Informacionin ose vendndodhjen e shërbimeve që mund të përdoren për të njohur statusin e vlefshmërisë së vërtetimit të kualifikuar.

## **ANEKSI VI**

### **Lista minimale etributeve**

Në bazë të nenit 61 Autoriteti siguron marrjen e masave për të lejuar ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar të vërtetimeve elektronike tëtributeve, të verifikojnë me mjete elektronike, me kërkesë të përdoruesit, vërtetësinë etributeve të mëposhtme kundrejt burimit përkatës autentik në nivel kombëtar ose nëpërmjet ndërmjetësve të caktuar në nivel kombëtar, në përputhje me kombëtar dhe kur këtotribute mbështeten në burime autentike brenda sektorit publik, si :

1. adresa;
2. moshë;
3. Gjinia;
4. Statusi civil;
5. Përbërja e familjes sipas certifikates familjare;
6. Kombësia ose shtetësia;
7. Kualifikimet arsimore, titujt dhe licencat;
8. Kualifikimet, titujt dhe licencat profesionale;
9. Kompetencat dhe autorizimet për të përfaqësuar personat fizikë ose juridikë;
10. Lejet dhe licencat publike;
11. Për personat juridikë, të dhënat financiare dhe të shoqërisë.

## **ANEKSI VII**

**Kërkesat për vërtetimin elektronik tëtributeve të lëshuara nga ose në emër të një organi publik përgjegjës për një burim autentik**

[Type here]

Një vërtetim elektronik i atributëve i lëshuar nga ose në emër të një organi publik përgjegjës për një burim autentik përmban:

- a) një tregues, në një format të përshtatshëm për përpunim të automatizuar, që tregon që vërtetimi është lëshuar si një vërtetim elektronik i atributëve nga ose në emër të një organi publik përgjegjës për një burim autentik;
- b) një grup të dhënash që përfaqësojnë në mënyrë të qartë organin publik përgjegjës që lëshon vërtetimin elektronik të atributëve, duke përfshirë, shtetin në të cilin është krijuar ai organ publik, emrin e tij dhe, sipas rastit, numrin e tij të regjistrimit si figuron në të dhënat zyrtare;
- c) një grup të dhënash që përfaqësojnë qartësisht subjektin të cilit i referohen atributet e vërtetuara dhe nëse përdoret një pseudonim, duhet të tregohet në mënyrë të qartë;
- d) atributin ose atributet e vërtetuara, duke përfshirë, aty ku është e aplikueshme, informacionin e nevojshëm për të identifikuar qëllimin e këtyre atributëve;
- e) datën e fillimit dhe përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së vërtetimit;
- f) kodin e identifikimit të vërtetimit, i cili është unik për organin publik lëshues dhe, aty ku është e aplikueshme, një tregues të skemës së vërtetimeve ku bën pjesë ky vërtetim i atributëve;
- g) nënshkrimin elektronik të kualifikuar ose vulën elektronike të kualifikuar të autoritetit lëshues;
- h) vendndodhjen ku leshohet certifikata për nënshkrimin elektronik të kualifikuar ose vulën elektronike të kualifikuar të përmendur në shkronjën g, e cila ofrohet pa pagesë;
- i) informacionin ose vendndodhjen e shërbimeve që mund të përdoren për të njohur statusin e vlefshmërisë së vërtetimit.

[Type here]